




Afrim Shala dhe Agim Maliqi

Veprat penale të armëve Komentar

Afrim Shala dhe Agim Maliqi

Veprat penale të armëve Komentar

Prishtinë, 2024

© Kombet e Bashkuara, 2024. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara në mbarë botën.

Heqje përgjegjësie

Emërtimet e përdorura dhe mënyra e paraqitjes së materialit në këtë dokument nuk nënkuptojnë shprehje të opinionit nga ana e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara lidhur me statusin ligjor të asnjë vendi, territori, qyteti a zone, apo të autoriteteve të tyre, apo lidhur me përcaktimin e kufijve të tyre të brendshëm apo të jashtëm. Pikëpamjet e shprehura në këtë punim kërkimor janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Kombeve të Bashkuara (KB), duke përfshirë Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC), apo të shteteve anëtare të KB-së.

Falënderime

Ky dokument u hartua nga Seksioni i Trafikimit të Armëve të Zjarrit (FTS), Dega e Krimit të Organizuar dhe Trafikut të Paligjshëm, Divizioni i Çështjeve të Traktateve pranë UNODC-së, nën mbikëqyrjen e përgjithshme nga znj. Simonetta Grassi, udhëheqëse e FTS-së. Dokumenti u përgatit nga z. Afrim Shala dhe z. Agim Maliqi, gjyqtarë të Gjykatës Supreme të Kosovës¹. Ky botim u përgatit falë mbështetjes financiare të ofruar nga: Gjermania, Suedia, Holanda, Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Norvegjia, përmes Fondit Shumë-Partnerësh të Mirëbesimit për implementimin e Udhërrëfyesit për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta (SALW) në Ballkanin Perëndimor, si dhe me mbështetjen e Bashkimit Evropian (BE). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë mënyrë si pasqyrim i opinionit zyrtar të këtyre vendeve apo subjekteve.



1 Referencat për Kosovën në këtë publikim kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Shkurtesa

BE	Bashkimi Evropian
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GFP	Programi Global i Armëve të Zjarrit
GjEDNj	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KB	Kombet e Bashkuara
KE	Këshilli i Evropës
KEDNj	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KFOR	Prania ndërkombëtare e sigurisë e vendosur në territorin e Kosovës në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, e përbërë nga Organizata e Paktit të Veriatlantikut (NATO), duke përfshirë shtetet anëtare, organet ndihmëse, shtabet ushtarake dhe elementet ose njësitet kombëtare përkatëse, si dhe vendet kontribuuese që nuk janë anëtare në NATO.
MSA	Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
SALW	Fondi Shumë-Partnerësh i Mirëbesimit për implementimin e Udhërrëfyesit për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta në Ballkanin Perëndimor
UNMIK	Prania ndërkombëtare civile e vendosur në territorin e Kosovës në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, e cila përfshinte komponentë të policisë dhe të gjyqësisë, komponentë të administratës së përkohshme civile (Kombet e Bashkuara), ndërtimit të institucioneve (OSBE) dhe rindërtimit (BE).
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
UNTOC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional

Përmbajtja

PJESA E PARË

Vështrime të përgjithshme, historike, legjislative
dhe ndërkombëtare të veprave penale të armëve

1. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME	12
2. VËSHTRIM I SHKURTËR HISTORIK I VEPRAVE PENALE TË ARMËVE	14
2.1 Shqyrtime të përgjithshme	14
2.2 Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (1977)	15
2.3 Rregullorja e UNMIK-ut për Autorizimin e Posedimit të Armëve në Kosovë (2001)	16
2.4 Kodi Penal i Kosovës (2004)	18
2.5 Kodi Penal i Kosovës (2013)	19
3. LIGJET PËRKATËSE TË ARMËVE DHE ARMËT	23
3.1 Shqyrtime të përgjithshme	23
3.2 Ligji për Armë	23
3.3 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative	25
3.4 Ligji për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore të sigurisë	25
3.5 Armët dhe kategorizimi i tyre	26
3.5.1 Armët dhe kategorizimi i tyre sipas KPK-së	26
3.5.2 Armët dhe kategorizimi i tyre sipas Ligjit për Armë	29
3.5.3 Armët e zjarrit dhe kategorizimi i tyre	32
3.5.4 Leja për lëvizje me armë	35
3.6 Domosdoshmëria e harmonizimit të legjislacionit vendor në raport me trendet bashkëkohore në fushën e armëve të zjarrit	36
4. DISA DOKUMENTE TË RËNDËSISHME NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E ARMËVE TË ZJARRIT	39
4.1 Shqyrtime të përgjithshme	39

4.2 Protokolli kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit	41
4.3 Direktiva (BE) 2021/555 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 24.03.2021, për kontrollin e blerjes dhe posedimit të armëve	45

PJESA E DYTË

Veprat penale të armëve

1. SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME	48
2. IMPORTI, EKSPORTI, FURNIZIMI, TRANSPORTIMI, PRODHIMI, KËMBIMI, NDËRMJETËSIMI OSE SHITJA E PAAUTORIZUAR E ARMËVE APO MATERIEVE PLASËSE (NENI 364, KPK)	50
2.1 Shqyrtime të përgjithshme	50
3. FSHIRJA, HEQJA APO NDRYSHIMI I KUNDËRLIGJSHËM I SHENJAVE NË ARMË TË ZJARRIT APO NË MUNICION (NENI 365, KPK)	57
3.1 Shqyrtime të përgjithshme	57
4. MBAJTJA NË PRONËSI, KONTROLL OSE POSEDIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE (NENI 366, KPK)	60
4.1 Shqyrtime të përgjithshme	60
5. PËRDORIMI I ARMËS APO MJETIT TË RREZIKSHËM (NENI 367, KPK)	66
5.1 Shqyrtime të përgjithshme	66
6. LEJET, PËLQIMET DHE LICENCAT E RREME TË ARMËVE DHE DHËNIA E INFORMATAVE TË RREME (NENI 368, KPK)	71
6.1 Shqyrtime të përgjithshme	71
7. PRODHIMI DHE SIGURIMI I ARMËVE DHE MJETEVE PËR KRYERJEN E VEPRAVE PENALE (NENI 369, KPK)	74
7.1 Shqyrtime të përgjithshme	74
8. BIBLIOGRAFIA	77

Hyrje

Ky publikim është autorizuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin² në kuadër të Programit Global të Armëve të Zjarrit (GFP).³ Nga viti 2011, UNODC filloi të zbatojë GFP-në për të ndihmuar shtetet anëtare në parandalimin e trafikut të paligjshëm ndërkombëtar të armëve të zjarrit, përmes ratifikimit dhe implementimit të Protokollit kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve,⁴ që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional (UNTOC).⁵

Ndërsa, nga viti 2020, UNODC përmes GFP-së, u ofron mbështetje shteteve të Ballkanit Perëndimor, në lidhje me harmonizimin e legjislacionit të tyre me Protokollin e lartcekur të Kombeve të Bashkuara për armët e zjarrit, në rritjen e kapaciteteve të tyre institucionale për të parandaluar, zbuluar dhe ndaluar flukset e paligjshme të armëve të zjarrit, si dhe për të mbledhur dhe shkëmbyer të dhëna lidhur me armët e zjarrit.

Në funksion të arritjes së synimeve të lartcekura, është edhe mbështetja e dhënë për përgatitjen e publikimeve të ndryshme në shtetet e Ballkanit Perëndimor që ndërlidhen me posedimin e kundërligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të zjarrit.

Ky publikim, në formatin e komentarit, ka për qëllim të paraqesë para profesionistëve të drejtësisë një pasqyrë të përgjithshme, historike, ligjore dhe ndërkombëtare të shumë çështjeve që ndërlidhen me armët, ku me këtë rast, do të analizohen dispozitat ligjore që rregullojnë çështjet e lartcekura, nga disa dimensione.

Në radhë të parë, trajtohet aspekti i përgjithshëm dhe historik i zhvillimit të legjislacionit penal në Kosovë, pas vitit 1999 e deri më tani. Në këtë pjesë, paraqitet një analizë e dispozitave ligjore që rregullojnë çështjet e lartcekura, ku në këtë drejtim, fillimisht janë trajtuar dhe shtjelluar rregulloret e UNMIK-ut, si dhe dispozitat përkatëse të ligjeve/kodeve penale, pas shfuqizimit të këtyre rregulloreve.

Në kuadër të këtij publikimi janë trajtuar edhe dispozitat e aplikueshme të ligjeve përkatëse që rregullojnë çështje nga fusha e armëve në përgjithësi, dhe armëve të zjarrit në veçanti, si

2 <https://www.unodc.org/>

3 <https://www.unodc.org/unodc/en/firearms-protocol/>

4 <https://www.unodc.org/unodc/en/firearms-protocol/the-firearms-protocol.html>

5 https://treaties.un.org/pages/VieDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XVIII-12&chapter=18&clang=en

dhe janë paraqitur disa kategorizime të armëve, duke mos e lënë anash as çështjen e nevojës së harmonizimit të legjislacionit tonë me aktet e ndryshme ndërkombëtare dhe trendet bashkëkohore të prodhimit të armëve të zjarrit.

Në këtë punim, rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe paraqitjes dhe trajtimit të disa dokumenteve të rëndësishme ndërkombëtare që rregullojnë çështje nga fusha e armëve të zjarrit, si në nivel të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ashtu edhe në nivel të Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Evropian.

Ndërsa, në pjesën e dytë, janë trajtuar dhe interpretuar elementet e figurave të veprave penale të armëve sipas pjesës së posaçme të Kodit Penal të Kosovës, ku trajtimi dhe interpretimi i elementeve të figurave të këtyre veprave penale është bërë edhe përmes paraqitjes së rasteve konkrete nga praktika jonë gjyqësore.

Prishtinë, 2024

Autorët

Afrim Shala dhe Agim Maliqi

PJESA E PARË

Vështirime të përgjithshme,
historike, legjislative dhe
ndërkombëtare të veprave
penale të armëve

1. Shqyrtime të përgjithshme

Një nga problemet me të cilët është përballur Kosova pas vitit 1999, ka qenë edhe çështja e posedimit të paautorizuar të armëve nga ana e qytetarëve. Në këtë drejtim, me qëllim të zvogëlimit të numrit të armëve të paautorizuara, pas vitit 1999, në Kosovë disa herë janë përcaktuar afate për dorëzimin vullnetar të armëve tek autoritetet përkatëse. Kjo për faktin se rreziku që i kanosej shoqërisë kosovare nga posedimi i paautorizuar i armëve, vazhdon të mbetet tejet i madh. Posedimi i paautorizuar i armëve të zjarrit nga qytetarët në Kosovë konsiderohet shkaktari kryesor për pjesën dërrmuese të vrasjeve dhe të një sërë veprave tjera penale. Gjithashtu, posedimi i paautorizuar i armëve përbën rrezik edhe për institucionet e sigurisë përfshirë: Policinë e Kosovës, Forcën e Sigurisë së Kosovës, KFOR-in, etj.

Sipas vlerësimeve dhe statistikave të organizatave të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, rezultojnë se shumica absolute e veprave penale që kryhen me armë zjarri, kryhen me armë që janë poseduar në mënyrë të paautorizuar.

Në këtë mënyrë, siç do të shohim në vijim të këtij punimi, me qëllim të luftimit të kësaj dukurie të dëmshme për shoqërinë, posedimi i paautorizuar i armëve, ngjashëm sikurse edhe në shtetet tjera bashkëkohore, edhe në vendin tonë konsiderohet vepër penale. Jo vetëm kjo, por edhe ndërmarrja e veprimeve tjera në mënyrë të paautorizuar lidhur me armët janë të parashikuara si vepra penale në legjislacionin tonë penal, përkatësisht në KPK.⁶

Gjithashtu, siç do të shohim, në pjesën e posaçme të KPK-së, ndër kapitujt më të rëndësishëm konsiderohet edhe Kapitulli XXIX, në të cilën janë parashikuar veprat penale të armëve,⁷ në të cilin Kapitulli janë parashikuar gjashtë (6) vepra penale që kanë të bëjnë me armët, të cilat do të shtjellohen më gjerësisht në pjesën e dytë të këtij punimi.

Përveç parashikimit të veprave penale, në kuadër të Kapitullit XXIX gjenden edhe disa dispozita ligjore me karakter shpjegues, pasi me to shtjellohet domethënia e shprehjeve që janë përdorur në kuadër të elementeve përkatëse të figurës së veprës penale,⁸ kjo me qëllim të interpretimit sa më të lehtë të këtyre veprave penale.

6 Kodi Penal i Kosovës, nr. 06/L-074, datë 23.11.2018 (në tekstin e mëtejshëm: KPK). KPK mund të gjendet në këtë link: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

7 Shala, Afrim, *Hyrje në të drejtën penale*, Botimi i katërt, Prishtinë, 2023, f. 28.

8 Shala, Afrim, *Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore*, Gjilan, 2010, f. 31.

Tjetër aspekt i rëndësishëm i këtij Kapitulli të veprave penale, është edhe parashikimi i dhënë shprehimisht për konfiskimin e armëve. Armët e konfiskuara në shumicën e rasteve është parashikuar të shkatërrohen,⁹ mirëpo në situata të caktuara, duhet shikuar mundësinë që armët e tilla t'i dorëzohen në shfrytëzim edhe Policisë së Kosovës, sipas procedurave të parashikuara me ligj.¹⁰

9 Policia e Kosovës më 12.09.2024, bëri shkatërrimin e një sasive të konsiderueshme të armëve të zjarrit dhe pajisjeve të ndryshme të paligjshme. Në njoftimin për media të Policisë së Kosovës thuhet se ky është një hap vendimtar drejt sigurisë më të madhe në Kosovë, duke dërguar një mesazh të gjithë qytetarët, brenda dhe jashtë kufijve, se Kosova është e vendosur për të mbajtur sundimin e ligjit, për të ruajtur rendin dhe sigurinë publike, si dhe për të larguar armët ilegale. Në baza vjetore, Policia e Kosovës konfiskon mesatarisht rreth 1.500 armë të llojeve të ndryshme, duke përfshirë numër relativisht të madh të municionit të kalibrave të ndryshëm, si dhe mjeteve të ndryshme plasëse, duke përfshirë edhe eksplozivët artizanale, përderisa në këtë ceremoni me vendim të gjykatës, është lejuar shkatërrimi i 993 armëve të zjarrit, prej tyre 372 armë të gjata dhe 621 armë të shkurtra, si dhe pajisje të tjera. <https://telegrafi.com/shkatërrohen-993-arme-te-llojeve-te-ndryshme-si-dhe-pajisje-te-ndryshme-ilegale/>

10 Kështu, në nenin 487, paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Penale (Kodi nr. 08/L-032, datë 14.07.2022) është parashikuar se “Nëse aktgjykimi përmban urdhrin për konfiskimin e pasurisë, prona e tillë automatikisht bëhet pronë e shtetit. Një kopje e vërtetuar e aktgjykimit të formës së prerë duhet t’i dërgohet menjëherë Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, të cilat mund t’i shesin objektet ose t’i vendosin ato në përdorim të Qeverisë”. Kurse, në nenin 277, paragrafi 6 të KPP, është parashikuar se “Prokurori i shtetit mund të kërkojë që pasuria e specifikuar të mbahet për shfrytëzim nga Qeveria e Kosovës”. KPP mund të gjendet në këtë link: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61759>

2. Vështrim i shkurtër historik i veprave penale të armëve

2.1 Shqyrtime të përgjithshme

Duke u bazuar në nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, datë 12.12.1999, për Ligjin në fuqi në Kosovë, e cila ishte ndryshuar më pastaj me Rregulloren nr. 2000/59, datë 27.10.2000, ligji në fuqi në Kosovë, pas datës 10.06.1999, përfshinte:

- (a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to, dhe
- (b) Legjislacioni që ishte në fuqi në Kosovë më 22.03.1989.

Në këtë mënyrë, për sa i përket të drejtës penale, prej 10.06.1999, në Kosovë aplikohet Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, datë 01.07.1977; Ligji Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, datë 01.07.1977, si dhe për disa vepra penale të caktuara edhe Ligji Penal i Republikës Socialiste të Serbisë, datë 01.07.1977, ndërsa këto ligje janë aplikuar derisa nuk janë shfuqizuar me ligje të tjera penale.

Edhe për sa i përket armëve të zjarrit, pas 10.06.1999 e deri më tani, çështjet penale janë rregulluar dhe parashikuar me këto akte juridike:

- 1) Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, që kishte hyrë në fuqi më 01.07.1977;
- 2) Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/7 mbi Autorizimin e Posedimit të Armëve në Kosovë që kishte hyrë në fuqi më 04.06.2001;
- 3) Kodi Penal i Kosovës, që kishte hyrë në fuqi më 06.04.2004;
- 4) Kodi Penal i Kosovës, që kishte hyrë në fuqi më 01.01.2013, si dhe
- 5) Kodi Penal i Kosovës, i cili është në fuqi aktualisht.

2.2 Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (1977)

Në Ligjin Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (në vijim: LPK) kanë qenë të parashikuara dy (2) vepra penale në fushën e armëve :

- 1) Vepra penale **“Punimi dhe vënia në dorë e armëve dhe e mjeteve të destinuara për kryerjen e veprave penale”**, e parashikuar në nenin 198 të LPK-së, dhe
- 2) Vepra penale **“Mbajtja pa leje e armëve ose e materieve plasëse”**, e parashikuar në nenin 199 të LPK-së.

Vepra penale “Punimi dhe vënia në dorë e armëve dhe e mjeteve të destinuara për kryerjen e veprave penale”, e parashikuar në nenin 198 të LPK-së, ka përmbytur dy (2) forma të kryerjes së saj dhe atë: formën themelore të parashikuar në paragrafin 1 dhe formën e lehtë të parashikuar në paragrafin 2.

Formën themelore të kësaj vepre penale e ka kryer kushdo që armët, materiet plasëse, ose mjetet e nevojshme për përgatitjen e tyre, si dhe helmet për të cilat e ka ditur se janë të destinuara për kryerjen e veprës penale, i ka punuar, i ka vënë në dorë ose tjetrit i ka bërë të mundur për t'i vënë në dorë. Për këtë formë të kësaj vepre penale ishte parashikuar dënimi me burgim prej gjashtë (6) muajve deri në pesë (5) vjet. Kurse, formën e lehtë të kësaj vepre penale e ka kryer kushdo që ka punuar ose i ka dhënë jep tjetrit çelës të rremë, kallauz ose ndonjë mjet tjetër për të depërtuar edhe pse e ka ditur se është i destinuar për kryerjen e veprës penale. Për këtë formë të lehtë të kësaj vepre penale ishte parashikuar dënimi me burgim deri në një (1) vit.

Ndërsa, vepra penale “Mbajtja pa leje e armëve ose e materieve plasëse”, e parashikuar me nenin 199 të LPK-së, ka përmbytur tri (3) forma të kryerjes së saj dhe atë: formën themelore të parashikuar në paragrafin 1; formën e lehtë të parashikuar në paragrafin 2 dhe formën e kualifikuar të parashikuar në paragrafin 3.

Formën themelore të kësaj vepre penale sipas paragrafit 1 e ka kryer kushdo që pa autorizim ka punuar, shitur, vënë në dorë ose ka bërë shkëmbimin e armëve të zjarrit, të municionit ose materieve eksplozive, ose kushdo që pa autorizim kishte mbajtur armë zjarri, municion ose materie eksplozive, vënia në dorë e të cilave qytetarëve nuk i është lejuar fare. Për këtë formë themelore të kësaj vepre penale ishte parashikuar dënimi me burgim deri në tre (3) vjet. Formën e lehtë të kësaj vepre penale e ka kryer kushdo që pa lejen e organit kompetent kishte mbajtur ose bartur dy ose më shumë armë zjarri. Pra, siç shihet, mbajtja ose bartja pa leje të organit kompetent e dy (2) ose më shumë armëve të zjarrit ishte konsideruar vepër penale, kurse mbajtja ose bartja pa leje të organit kompetent e një (1) arme të zjarrit ishte konsideruar kundërvajtje. Për këtë formë të lehtë të kësaj vepre penale ishte parashikuar dënim me burgim deri në një (1) vit. Kurse, forma e kualifikuar e kësaj vepre penale konsiderohej se është kryer nëse forma themelore nga paragrafi 1 përfshinte sasi të madhe të

armëve të zjarrit, municionit ose materieve eksplozive. Për këtë formë të kualifikuar të kësaj veprë penale ishte parashikuar dënimi me burgim prej një (1) deri në (10) vjet.

2.3 Rregullorja e UNMIK-ut për Autorizimin e Posedimit të Armëve në Kosovë (2001)¹¹

Njëri prej akteve juridike të para që ishte nxjerrë pas vitit 1999 në Kosovë e që i referohet armëve është edhe Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/7 për Autorizimin e Posedimit të Armëve në Kosovë, e nënshkruar më 21.02.2001, nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, z. Hans Hækkerup, ndërsa kishte hyrë në fuqi më 04.06.2001.

Sipas kësaj Rregulloreje, “arma” është përkufizuar si instrument i disenjuar, i përdorur apo i përdorshëm për të shkaktuar dëmtim trupor. Kjo përfshin, ndër të tjera, të gjitha llojet e municionit, harqet dhe shigjetat, sprejin, gazin CS, armët me qorrfisheskë, armët imituese, armët për alivanosje, taserët (mjetet që punojnë në bazë të elektrohokut) dhe të gjitha llojet e armëve të paraqitura në Aneksin A të kësaj rregulloreje apo armët e ngjashme.

Në Aneksin A të kësaj Rregullore, armët janë kategorizuar dhe përkufizuar si vijon: 1. Pushkë automatike; 2. Pushkë gjysmautomatike; 3. Pushkë me shul; 4. Revole automatike; 5. Revole gjysmautomatike; 6. Revolver; 7. Mitraloz i lehtë; 8. Mitraloz i rëndë; 9. Armë e diaktivizuar; 10. Mortajat; 11. Top anti-tank; 12. Armë kundërajrore; 13. Granatë (bombë dore) thërrmuese; 14. Bombë paralizuese; 15. Minë kundërnjerëzore; 16. Minë antitank; 17. Eksplozivat; 18. Municion për armë të lehta; 19. Municion për përkrahjen e armëve; 20. Municion i armëve të zjarrit indirekt; 21. Armët e gjuetisë dhe 22. Armët rekreative.

Në nenin 2 të kësaj Rregullore, ishte parashikuar se Policia e UNMIK-ut, ishte organi i vetëm përgjegjës për lëshimin e lejeve për armëmbajtje (në vijim: “LA”), me përjashtim të armëve të autorizuara nga KFOR-i.

Kurse, në nenin 8 të kësaj Rregulle kanë qenë të parashikuara veprat penale në fushën e armëve dhe dënimet për këto vepra penale. Kështu, në këtë dispozitë kanë qenë të parashikuara këto vepra penale:

- (a) “Zotërimi, kontrollimi, posedimi apo përdorimi i armës nga cildo person që nuk ka LA të vlefshme paraqet veprë penale” dhe i është nënshtruar dënimit me burgim deri në kohëzgjatje jo më shumë se 8 vjet ose me të holla deri në 15.000 DM,¹² ose të dyja së bashku. Çdo lloj leje që i është lëshuar atij personi automatikisht i është anuluar.

11 https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2001regs/RA2001_07.pdf

12 DM-“Deutsche Mark”/marka gjermane.

- (b) “Përdorimi apo vringëllimi i çfarëdo arme nga cilido person në mënyrë kërcënuese, frikësuese apo në ndonjë mënyrë tjetër të paautorizuar, si dhe atëherë kur ai e poros-it bashkëfajtorin të bëjë një gjë të tillë paraqet vepër penale” dhe i është nënshtruar dënimit me burgim deri në 10 vjet ose me të holla deri në 20.000 DM, apo të dyja së bashku, si dhe personit të tillë, i anulohet automatikisht çdo lloj LA-je e lëshuar;
- (c) “Çdo person i pajisur me LA bënte vepër penale nëse nuk e njoftonte Policinë e UNMIK-ut për çdo ndërrim të pronësisë, posedimit apo kontrollit të armës së autorizuar” dhe është dënuar me dënim me burgim deri në kohëzgjatje jo më shumë se 8 vjet ose me të holla deri në 15.000 DM, ose të dyja së bashku. Çdo lloj leje që i ishte lëshuar atij personi automatikisht anulohet;
- (d) “Çdo person që jep informata të rrejshme gojarisht apo me shkrim në cilëndo fazë të procedurës së kërkimit të LA-së bën vepër penale” dhe për këtë vepër penale parashihej dënimi me burgim në kohëzgjatje jo më shumë se 3 vjet apo me të holla deri në 10.000 DM, ose të dyja së bashku, si dhe personit të tillë, automatikisht i anulohet LA-ja e lëshuar;
- (e) “Vepër penale paraqet për çdo person edhe prodhimi, posedimi, shitja apo blerja e LA-së falso” dhe për këtë vepër penale parashihej dënimi me burgim në kohëzgjatje jo më shumë se 3 vjet apo me të holla deri në 10.000 DM, ose të dyja së bashku, si dhe personit të tillë, automatikisht i anulohet LA-ja e lëshuar;
- (f) “Vepër penale bën çdo person i cili ka LA dhe dështon t’ua tregojë menjëherë armën organeve përgjegjëse të rendit kur këtë e kërkojnë, ose kur arma nuk është në posedim të tij a të saj apo kur nuk i informon organet përgjegjëse të rendit për vendndodhjen e armës” dhe për këtë vepër penale parashihej dënim me burgim jo më shumë se 3 muaj ose me të holla deri në 5000 DM, apo të dyja së bashku, si dhe personit të tillë, i anulohet automatikisht LA-ja e lëshuar;
- (g) “Vepër penale edhe atëherë kur personi që mban LA nuk e informon Policinë e UNMIK-ut për çdo ndryshim të adresës së banimit, për të cilën gjë është i obliguar ta njoftojë Policinë e UNMIK-ut brenda afatit prej 15 ditëve pas ndërrimit të adresës” dhe për këtë vepër penale parashihej dënim me burgim jo më shumë se 3 muaj ose me të holla deri në 5.000 DM, apo të dyja së bashku, si dhe personit të tillë i anulohet automatikisht LA-ja e lëshuar.

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se Komisari i Policisë së UNMIK-ut mund të konfiskonte pa kompensim çdo armë të paautorizuar ose çdo armë të autorizuar që nuk përdorej ose që nuk mbahej në përputhje me rregullat dhe kushtet e LA-së. Armët e tilla të konfiskuara mund të shkatërroheshin apo të përdoreshin për qëllimet e policisë së UNMIK-ut.

Përveç këtyre, me këtë Rregullore kanë qenë të rregulluara edhe shumë çështje tjera që i referohen lëshimit të lejeve për armëmbajtje, pastaj verifikimet e personave që kanë aplikuar për LA, refuzimi, pezullimi apo anulimi i LA-së, vlefshmëria e LA-së, etj.

2.4 Kodi Penal i Kosovës (2004)¹³

Pas tre vjet e gjysmë pune të vazhdueshme dhe intensive, në fillim të marsit të vitit 2003, ishte përgatitur versioni përfundimtar i Kodit Penal të Kosovës, i cili më pastaj iu dërgua Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës. Pas shqyrtimit të këtij Kodi nga këto organe më të larta të pushtetit në Kosovës, me disa vërejtje dhe sugjerime, Kodi Penal iu dërgua Zyrës së UNMIK-të, meqë në atë kohë, Kosova administrohej nga Kombet e Bashkuara, dhe autorizimet për nxjerrjen e ligjeve penale ishin kompetencë e rezervuar. Së këndejmi, Kodi Penal i Kosovës ishte miratuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, z. Michael Steiner, më 06.07.2003, ndërsa kishte hyrë në fuqi më 06.04.2004.¹⁴

Kodi Penal i Kosovës u shpall me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2003/25, datë 06.07.2003 dhe ishte në fuqi deri më 31.12.2012.

Fillimisht, ky Kod ishte emërtuar “Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës”, mirëpo, më vonë, me Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit Penal të Përkohshëm të Kosovës,¹⁵ në titullin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe në tërë tekstin e këtij kodi, togfjalëshi “Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës” ishte zëvendësuar me togfjalëshin “Kodi Penal i Kosovës” (KPK).

Në dispozitat ligjore të KPK-së, shprehja “armë” është përkufizuar si një mjet i prodhuar që përdoret ose është i përshtatshëm të përdoret për të shkaktuar lëndime trupore. Në mes tjerash, përfshinte të gjitha llojet e municionit, shigjetat automatike, harqet, shigjetat, sprejin, gazin lotsjellës, armët me qorrfishëkë, armët imituese, armët alivanosëse, taserët (mjetet që punojnë në bazë të elektroshokut) dhe të gjitha kategoritë e armëve të paraqitura në Tabelën A të bashkëngjitur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/7 mbi Autorizimin e Posedimit të Armëve në Kosovë ose armë të ngjashme, por nuk kufizohet vetëm me to.¹⁶

Në dispozitat e pjesës së posaçme të KPK-së kanë qenë të parashikuara katër (4) vepra penale të armëve të cilat ishin të sistemuara në kuadër të Kapitullit të veprave penale kundër rendit publik dhe veprimeve juridike (Kapitulli XXVIII).

Në nenin 327 të KPK-së, ishte parashikuar vepra penale “Furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve”. Formën themelore të kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1 të këtij neni, e kryente “Kushdo që furnizon, transporton, prodhon, këmben ose shet armë pa autorizim”, për të cilën ishte parashikuar dënim me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim prej një deri në tetë vjet. Kurse, forma e rëndë e kësaj vepre penale, konsiderohej se është kryer, nëse bëhej fjalë për “sasi të madhe armësh”, për të cilën ishte parashi-

13 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8674>

14 Salihu, Ismet: *E drejta penale*, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015, fq.117.

15 Ligji nr. 03/L-002 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, datë 06.11.2008. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2601>

16 Neni 108, paragrafi 28, KPK.

kuar dënim me burgim prej një deri në dhjetë vjet, ndërsa, në paragrafin 3 të këtij neni, ishte parashikuar konfiskimi i detyrueshëm i armëve.

Në nenin 328 të KPK-së ishte parashikuar vepra penale “Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve”, formën themelore të së cilës e kryente “Kushdo që përdor apo vringëllon armët me frikësim, kërcënim ose në ndonjë mënyrë tjetër të paautorizuar apo urdhëron personin tjetër të veprojë në mënyrë të njëjtë”, për të cilën ishte parashikuar dënim me gjobë deri në 10.000 euro ose me burgim prej një deri në dhjetë vjet. Formë e veçantë e kësaj vepre penale ishte parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, të cilën e kryente “Kushdo që mban në pronësi, kontrollon, posedon ose përdor armë pa lejen valide për mbajtjen e autorizuar të armëve për atë armë”, për të cilën ishte parashikuar dënim me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim prej një deri në tetë vjet. Kurse, në paragrafin 3 të këtij neni, ishte parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohej se ishte kryer nëse forma e veçantë e kësaj vepre penale nga paragrafi 2 i këtij neni, përfshinte “sasi të madhe armësh”, për të cilën ishte parashikuar dënim me burgim prej një deri në dhjetë vjet. Formë tjetër e veçantë e kësaj vepre penale, ishte parashikuar edhe në paragrafin 4 të këtij neni, të cilën e kryente “Kushdo që nuk e njofton Policinë e UNMIK-ut për çfarëdo ndryshimi të pronësisë, posedimit ose kontrollit të armës së autorizuar”, për të cilën ishte parashikuar dënim me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim prej një deri në tetë vjet. Edhe te kjo vepër penale, ishte parashikuar konfiskimi i detyrueshëm i armëve të paautorizuara ose armëve të autorizuara që përdoren apo mbahen në kundërshtim me rrethanat dhe kushtet e lejes për mbajtjen e autorizuar të armëve.¹⁷

Përveç këtyre, në KPK kanë qenë të parashikuara si vepra penale edhe “Mosrespektimi i kushteve të lejes për mbajtjen e autorizuar të armëve” (neni 329) dhe “Prodhimi dhe furnizimi i armëve dhe i instrumenteve të projektuara për kryerjen e veprave penale” (neni 330).

2.5 Kodi Penal i Kosovës (2013)¹⁸

Siç u theksua edhe më parë, KPK kishte qenë në fuqi prej 06.04.2004 deri më 31.12.2012, ndërsa më 20.04.2012, Kuvendi i Kosovës e kishte miratuar Kodin Penal të Kosovës,¹⁹ i cili ishte publikuar në Gazetën Zyrtare më 19.07.2012, ndërsa kishte hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Sipas KPK-së, “armë” konsiderohej çdo send ose vegël e punuar me qëllim që nën presionin e gazrave, të cilat lirohen gjatë djegies së materieve shpërthyes, elektrike, gazrave nën presion ose energjisë tjetër potenciale, hedh predha në formë të një plumbi të vetëm, grumbulli prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose përbërësish të tjerë, që krijohet dhe përdoret për të

¹⁷ Neni 328, paragrafi 1, KPK.

¹⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2834>

¹⁹ Kodi nr.04/L-082 Penal i Kosovës, datë 20.04.2012.

shkaktuar lëndime trupore ose dëm fizik, qoftë edhe psikologjik, si dhe secili send tjetër, qëllimi kryesor i të cilit është kryerja e sulmit fizik ndaj integritetit fizik të njerëzve ose ndaj pasurisë. Shprehja armë po ashtu përfshinte municionin, pjesët dhe përbërësit e armëve, si dhe armët nukleare, biologjike dhe kimike.

Përveç këtyre, me dispozitat ligjore të KPK-së, ishte përcaktuar se këto në vijim janë armë:

1. armët e zjarrit; 2. armët e koleksionit; 3. armët pneumatike (ajrore); 4. armët që përdoren për shpërndarjen e gazit irritues; 5. armët shpërthyes; 6. armët me shigjeta; 7. armët e ftohta;²⁰ 8. armët për sinjalizim akustik dhe të dritës; 9. armët elektroskok dhe 10. armët me rrymë.

20 Gjykata Supreme e Kosovës në aktgjykimin Pml.nr.611/2023, datë 06.12.2023, ka sqaruar se çka konsiderohet “armë e ftohtë” në kuptim të dispozitave juridike penale dhe ka theksuar se jo në të gjitha rastet “thika” konsiderohet “armë e ftohtë”. Në këtë drejtim, në aktgjykimin e lartcekur, Gjykata Supreme e Kosovës kishte konstatuar se veprimet kryesë të të pandehurit R.B., të përshkruara në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk përbëjnë vepër penale, për shkak se si thika përkatëse, ashtu edhe kaçavida nuk e posedojnë atributin e “armës së ftohtë” që është element themelor i figurës së veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366, paragrafi 1 të KPK-së, për arsytet që do të paraqiten në vijim. Kështu, në nenin 366, paragrafi 1 të KPK-së është parashikuar se formën themelore të kësaj vepre penale e kryen “Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesë-qind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet”. Veprimet e kryerjes së kësaj forme të veprës penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në: mbajtjen në pronësi, kontroll ose posedim të armëve, dhe për t’u konsideruar se është kryer kjo formë e kësaj vepre penale, duhet që veprimet e kryerjes të jenë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla. Siç shihet, kjo dispozitë ligjore është e karakterit udhëzues, apo e ashtuquajtur “dispozitë blanketë”, pasi në lidhje me veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale udhëzon aplikimin e ligjit të zbatueshëm për armët, e që në këtë rast, ligji i zbatueshëm për armët është Ligji nr. 05/L -022 për Armë, datë 23.07.2015. Duke u bazuar në nenin 2, paragrafi 1.24. të këtij Ligji, “Armë e ftohtë” konsiderohet çdo mjet që mund të përdoret për sulm apo për shkaktim të lëndimeve trupore, duke përdorë forcë fizike nga sulmuesi në rastet kur ato mbahen, në tubime publike, në objekte publike apo në vende të ngjashme. Gjithashtu, në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se “Klasifikimi i tyre (“armëve të ftohta”) përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga organi kompetent”. Andaj, bazuar në këtë dispozitë ligjore, është e nevojshme të zbatohen edhe aktet nënligjore të nxjerra nga organi kompetent me të cilat është përcaktuar klasifikimi i armëve të ftohta. Në këtë drejtim, akt i tillë me të cilin është bërë klasifikimi i armëve të ftohta është Udhëzimi Administrativ nr.14/2010 (MPB) për Armët e Ftohta, datë 12.05.2010. Në nenin 2, paragrafi 1.2. të këtij Udhëzimi është parashikuar se “**Arma Melee** nënkupton armën e ftohtë të dizajnuar kryesisht për të mos përfshirë predhë apo të mos përdoret si e tillë, si dhe nga ana tjetër që përdoret për të therur apo qëlluar cakun në gjatësi të shtrirjes së dorës”, kurse në paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar se “Lista specifike (e armëve të ftohta) për nga nën-kategoritë gjendet në: Shtojcën 1 (armët qitëse) dhe Shtojcën 2 (armët Melee)”. Në Shtojcën 2 të këtij Udhëzimi janë përcaktuar Armët Melee, të cilat janë klasifikuar në tre (3) grupe dhe atë: 1) Armët e mprehta; 2) Armët e topitura dhe 3) Kombinim i armëve të mprehta dhe armëve të topitura. Mandej, armët e mprehta janë klasifikuar në dy (2) grupe dhe atë: 1) Thikat dhe 2) Shpatat. Ndërsa, në vijim të kësaj Shtojce janë përcaktuar llojet e thikave të cilat janë klasifikuar në dhjetë (10) grupe dhe atë në: **1. Thika hapëse anësore, thikë fshikull (“switch”)** (ose mjet tjetër i ngjashëm), që ka teahun që hapet automatikisht nga forca centrifugale ose e gravitetit ose nga shtypja e butonit, sustës ose pajisjes së brendshme ose të ngjitur në dorezën e thikës; **2. Thika balistike** që hedh tehe të ngjashme si thika të çfarëdo materiali përmes mjeteve që janë të ndryshme nga eksplozivët; **3. Thika hapëse frontale** që tërhiqet gjer në dorezë nga forca centrifugale ose e gravitetit ose nëse aplikohet shtypje në buton, sustë ose pajisje të ngjitur ose që formon pjesë të këllëfit, dorezës ose tehut të thikës. **4. Shpuesi me shtytje, thikë shtytëse apo thumb shtytës**, ose ndonjë pajisje tjetër që përbëhet nga tehet me një skaj të mprehtë ose shumë skaje të mprehta ose majë që ka dorezë të ngjitur tërthorazi për tehu ose maje, dhe mundëson tehun ose majën që të mbështeten për shuplake të dorës, ashtu që të mund të shkaktohet therje ose prerje përmes goditjes ose përmes shtypjes; **5. Thikë me dorezë me mbrojtëse për gishta** ose ndonjë pajisje që përbëhet nga tehet me një skaj të mprehtë ose shumë skaje të mprehta e pajisur me dorezë të ndërtuar nga substanca e fortë që mund të jetë e pajisur me dorezë me kanale për gishta të dorës së shfrytëzuesit për të mbrojtur gishtat dhe për të rritur efektin e goditjes ose shtyrjes, ose që është adaptuar për aso përdorimi; **6. Thikë flutur** ose ndonjë pajisje tjetër që përbëhet nga tehet me një skaj të mprehtë ose shumë skaje të mprehta, ose majë që kapet për dy doreza të ngjitura për tehu

Gjithashtu, me dispozitat ligjore të KPK-së, ishte përcaktuar se këto në vijim nuk konsiderohen armë për qëllime të këtij Kodi: 1. armët për qëllime industriale; 2. armët dekorative; 3. imitimi i armëve; 4. armët e zjarrit të bëra të papërdorshme (deaktivizuara) në mënyrë permanente me aplikimin e procedurave teknike që garantohen nga organi kompetent ose që njihen nga organi kompetent dhe 5. fuzhnjat për peshkim nën ujë.²¹

Në dispozitat e pjesës së posaçme të KPK-së kanë qenë të parashikuara gjashtë (6) vepra penale të armëve dhe atë:

- 1) “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse” (Neni 372);
- 2) “Fshirja, heqja apo ndryshimi i kundërligjshëm i shenjave në armë të zjarrit apo në municion” (Neni 373);
- 3) “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” (Neni 374);
- 4) “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” (Neni 375);
- 5) “Lejet, pëlqimet dhe licencat e rreme të armëve dhe dhënia e informatave të rreme” (Neni 376) dhe
- 6) “Prodhimi dhe sigurimi i armëve dhe mjeteve për kryerjen e veprave penale” (Neni 377).²²

ose majë përmes kunjave të tërthortë boshtor dhe ka mundësinë e hapjes përmes forcës centrifugale ose të gravitetit; **7. Thika yll** ose ndonjë pajisje tjetër që përbëhet nga një numër i pikave këndore, tehe ose maja të qitura jashtë rreth pikës së boshtit qendror dhe janë të dizajnuara për t’u rrotulluar rreth boshtit qendror gjatë fluturimit pasi që të hedhet në drejtim të caktut; **8. Thikat qitëse** të cilat thika pothuajse gjithmonë janë në një copë, në vend se thika tradicionale që e kanë të prodhuar dorezën ndaras nga brisku. Qëllimi i këtij prodhimi është krijimi i një thike të qëndrueshme me një shpërndarje të ekuilibruar të peshës. Përveç kësaj, disa thika qitëse janë me dy tehe, edhe pse skajet e thikave qitëse janë pothuajse gjithmonë të topitura (për të parandaluar thikën nga prerja e duarve flakës në disa kapje); **9. Bajonete** që është thikë e përshtatur për t’u vendosur në skajin e grykës së një pushke dhe e përdorur si armë në lufta të afërme dhe **10. Thika të pazbulueshme** të cilat janë thika që janë bërë nga kombinimi i materialeve të cilat nuk mund të zbulohen në mes detektorëve metal. Gjykata Supreme e Kosovës duke u bazuar në këtë që u theksua më lart, ka sqaruar se thikat si armë të mprehta janë të klasifikuara në dhjetë (10) grupe me karakteristikat e paraqitura më lart, ndërsa në këtë rast, thika që është konfiskuar nga i pandehuri R.B., nuk bën pjesë në asnjërën prej këtyre grupeve të thikave, andaj, edhe rrjedhimisht nuk konsiderohet as “armë e ftohtë” në kuptim të veprës penale për të cilën i njëjti ishte akuzuar dhe shpallur fajtor. Nga shkresat në dosjen e lëndës (në të cilën gjendet edhe thika) shihet që thika që është konfiskuar nga i pandehuri R.B., është një thikë që përdoret zakonisht në kuzhina të ndryshme për përgatitjen e ushqimit. Andaj, bazuar në arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës kishte ardhur në përfundim se në rastin konkret thika e lartcekur nuk konsiderohet “armë e ftohtë”, kështu që mbi bazën e saj edhe veprimet kryese të të pandehurit R.B., të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk përbëjnë elementet e veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366, paragrafi 1 të KPK-së. Në këtë mënyrë, Gjykata Supreme e Kosovës kishte vendosur që të miratojë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe t’i ndryshojë aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, duke e liruar nga akuza të pandehurin R.B.

21 Neni 120, paragrafi 38, KPK.

22 Këto vepra penale nuk janë shtjelluar më shumë në këtë pjesë, pasi kanë përmbajtje të njëjtë me veprat penale të armëve që janë të parashikuara në KPK-në që është në fuqi aktualisht.

Të gjashtë (6) këto vepra penale kanë qenë të sistemuara në një kapitull të veçantë të pjesës së posaçme të KPK-së të emërtuar “Veprat penale të armëve” - Kapitulli XXX-të.

Në këtë mënyrë, siç shihet, në KPK-në e vitit 2013, ishte parashikuar një përkufizim më i zgjeruar i armëve, ishte bërë një klasifikim i mjeteve që konsiderohen armë, si dhe i atyre që nuk konsiderohen armë, ishte rritur numri i veprave penale dhe për herë të parë, këto vepra penale u sistemuan në një kapitull të veçantë të pjesës së posaçme të KPK-së. Gjithashtu, togfjalëshi “sasi e madhe armësh” që më parë ishte kriter për kualifikimin e veprave penale, ishte zëvendësuar me shprehjen “më shumë se katër (4) armë apo më shumë se katërqind (400) fishekë”.

3. Ligjet përkatëse të armëve dhe armët

3.1 Shqyrtime të përgjithshme

S iç është theksuar edhe më lart, dispozitat ligjore të pjesës së posaçme të KPK-së përmes të cilave parashihen veprat penale të armëve janë dispozita ligjore me karakter udhëzues, apo të ashtuquajtura **“dispozita blanketë”**, pasi në lidhje me veprimet e kryerjes së këtyre veprave penale udhëzojnë aplikimin e ligjit të zbatueshëm për armët, e që në këtë rast, në parim, ligj i zbatueshëm për armët është Ligji nr. 05/L-022 për Armë, datë 23.07.2015.²³

Gjithashtu, ligje tjera të rëndësishme në këtë fushë konsiderohen edhe: Ligji nr. 03/L-246 për Pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri, datë 28.10.2010,²⁴ Ligji nr. 05/L-134 për Legalizimin dhe dorëzimin e armëve, municionit dhe mjeteve eksplozive, datë 31.03.2017,²⁵ si dhe disa ligje tjera që do të trajtohen në vijim të këtij punimi.

3.2 Ligji për Armë

Ligji nr. 05/L-022 për Armë, datë 23.07.2015²⁶ (në vijim: “Ligji për Armë”) konsiderohet ligj bazik në fushën e armëve në Kosovë dhe është njëri prej ligjeve më të rëndësishme në këtë fushë. Ky ligj është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 23.07.2015, ndërsa është botuar në Gazetën Zyrtare më 19.08.2015.

Duke pasur parasysh se dispozitat ligjore me të cilat janë parashikuar veprat penale të armëve referojnë në zbatimin e këtij Ligji, atëherë në vijim do të komentohen, trajtohen dhe shtjellohen dispozitat e këtij Ligji që janë vlerësuar të rëndësishme me rastin e vendosjes

²³ Me hyrjen e fuqi të këtij Ligji, ishte shfuqizuar Ligji i mëparshëm nr. 03/ L-143 për Armë, datë 17.09.2009.

²⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2737>

²⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=14605>

²⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11018>

dhe trajtimit të lëndëve të tilla nga gjyqtarët dhe prokurorët dhe që ndërlidhen në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë me elementet e figurave të veprave penale të armëve.

Fillimisht, duhet theksuar se në Ligjin për Armë rregullohen kushtet për blerjen, posedimin, armëmbajtjen, ruajtjen, prodhimin, çaktivizimin, riparimin, tregtimin, importimin, transitin, shitjen, transportimin dhe shënjimin e armëve dhe municionit për personat fizik dhe juridik, brenda territorit të Kosovës, si dhe eksportimin nga Kosova të destinuara vetëm për përdorim civil.²⁷

Ky Ligj synon të jetë në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 258/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14.03.2012, që implementon nenin 10 të Protokollit të Kombeve të Bashkuara kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional (Protokolli i Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit) dhe përcakton autorizimet për eksportin dhe importin, si dhe masat për kalimin transit të armëve, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit dhe Direktivën e Këshillit 91/477/KEE për kontrollin e marrjes dhe posedimit të armëve, e ndryshuar me Direktivën 2008/51/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 maj 2008.

Kurse, në anën tjetër, në dispozitat e këtij Ligji është sqaruar se tregtia e armatimit, pajisjeve, armëve, pjesëve të armëve dhe municionit, për qëllime ushtarake, i nënshtrohet Ligjit për Tregtinë e Mallrave Strategjike.²⁸ Dispozitat e këtij ligji, nuk zbatohen për armatim ushtarak, pajisje, armë, pjesë të armëve dhe municion, të dedikuar për nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe institucioneve tjera të autorizuara shtetërore të sigurisë.²⁹

Në dispozitat fillestare të këtij Ligji jepen përkufizimet e shprehjeve dhe shkurtesave që i referohen shumë çështjeve nga fusha e armëve në përgjithësi dhe të armëve të zjarrit në veçanti.

Me dispozitat ligjore të Ligjit për Armë është rregulluar edhe procedura dhe kushtet që duhen plotësuar për blerjen dhe posedimin e armës, si nga personat fizikë, ashtu edhe nga personat juridikë. Mandej, janë parashikuar llojet e lejeve që mund t'u lëshohen personave fizikë dhe personave juridikë, si dhe kushtet konkretet që duhet plotësuar.

Në këtë drejtim, në nenin 17 të Ligjit për Armë është parashikuar se lejet për personat fizikë janë: 1. leja për armëmbajtje të armës së zjarrit; 2. leja për armë koleksioni; 3. leja për armë gjahu; 4. leja për armë shenjëtarie; dhe 5. leja për armë të kategorisë D.

27 Neni 1, paragrafi 3 i Ligjit nr. 05/L-022 për Armë, datë 23.07.2015, parashikon "Tregtia e armatimit, pajisjeve, armëve pjesëve të armëve dhe municionit, për qëllime ushtarake, i nënshtrohet Ligjit për Tregtinë e Mallrave Strategjike", kështu që këto çështje nuk rregullohen me dispozitat e Ligjit për Armë.

28 Ligji nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike, datë 29.07.2013.

29 Neni 1, Ligji për Armë.

Kurse, për personat juridikë janë parashikuar këto lloje të lejeve: 1. leja për posedimin e armës; 2. leja për prodhim të armëve, pjesëve të armës dhe municionit të kategorisë A; 3. leja për riparim të armëve të kategorisë A; 4. leja për koleksion të armëve; 5. leja për tregti të armëve dhe municionit; 6. leja për transport të armëve; dhe 7. leja për armë të kategorisë D.

Gjithashtu, me Ligjin për Armë është rregulluar edhe procedura e sekuestrimit të licencës, lejes, armës, lejes së armës dhe municionit, në rastin kur personi fizik ose personi juridik nuk i përmbahet kriterëve të përcaktuara me këtë ligj.

3.3 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative³⁰

Ky Ligj ka për qëllim të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta të cilët rregullojnë procedura të veçanta administrative, duke siguruar garantimin e respektimit të parimeve të përgjithshme dhe nivelin e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave juridike të palëve, ashtu siç garantohet me Ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.

Me këtë Ligj janë plotësuar dhe ndryshuar disa ligje, në mesin e tyre edhe Ligji për Armë. Ligji për Armë është ndryshuar dhe plotësuar në pjesën administrative që ka të bëjë me verifikimin dhe konstatimin e plotësimit të kushteve të caktuara për dhënien e pëlqimit për blerjen e armëve, si për personat fizikë, ashtu edhe për personat juridikë, si dhe të drejtën e paraqitjes së ankesës nga pala e pakënaqur.

3.4 Ligji për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore të sigurisë

Ligji nr. 03/L-246 për Pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri, datë 28.10.2010,³¹ ka për qëllim përcaktimin

30 Ligji nr. 08/L-176 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 15.06.2023, ndërsa është botuar në Gazetën Zyrtare më 06.07.2023.

31 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2737>

e dispozitave ligjore lidhur me pajisjen me armë, municion dhe pajisje përkatëse për siguri për institucionet e autorizuar shtetërore të sigurisë.

Me këtë Ligj,³² rregullohet prodhimi, riparimi, tregtia, importi, eksporti, vënia e shenjave identifikuese, evidentimi, siguria gjatë deponimit dhe transportit, dhe vlerësimi i përputhshmërisë me kushtet për armët, municionin dhe pajisjet përkatëse për siguri për nevojat e institucioneve të autorizuar shtetërore të sigurisë.

Sipas dispozitave të këtij Ligji, institucionet e autorizuar shtetërore të sigurisë përfshijnë: Forcën e Sigurisë së Kosovës, Policinë e Kosovës, Inspektoratin Policor të Kosovës, Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Shërbimin Korrektues, Doganën e Kosovës, Agjencinë Pyjore të Kosovës, Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, si dhe institucionet tjera të autorizuar të cilat mund të krijohen me ligj të veçantë.

3.5 Armët dhe kategorizimi i tyre

Fillimisht duhet theksuar se përkufizimi i armëve dhe kategorizimi i tyre, në radhë të parë është i përcaktuar me dispozitat e KPK-së dhe të Ligjit për Armë, si dhe të ligjeve të tjera nga kjo fushë.

3.5.1 Armët dhe kategorizimi i tyre sipas KPK-së

Në nenin 113, paragrafi 40 të KPK-së është parashikuar se **“Armë”** konsiderohet çdo send ose vegël e punuar me qëllim që nën presionin e gazrave, të cilat lirohen gjatë djegies së materieve shpërthyes, elektrike, gazrave nën presion ose energjisë tjetër potenciale, hedh predha në formë të një plumbi³³ të vetëm, grumbulli prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose përbërësish të tjerë, që krijohet dhe përdoret për të shkaktuar lëndime trupore ose dëm fizik, qoftë edhe psikologjik, si dhe secili send tjetër, qëllimi kryesor i të cilit është kryerja e sulmit fizik ndaj integritetit fizik të njerëzve ose ndaj pasurisë.

Siç shihet, në këtë dispozitë ligjore është përcaktuar përkufizimi i armës në përgjithësi dhe si e tillë përfshin të gjitha sendet apo veglat e punuara me qëllim që nën presionin e gazrave të caktuara të hedhin predha në formë të një plumbi të vetëm, grumbulli saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose përbërësish të tjerë, si dhe secili send tjetër, qëllimi kryesor i të cilit është kryerja e sulmit fizik ndaj integritetit fizik të njerëzve ose ndaj pasurisë.

32 Ky Ligj është ndryshuar me Ligjin nr. 05/L -017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për Pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri, datë 23.07.2015.

33 Plumb është njësia e municionit për gëzhgojë moderne të armës së vogël, e cila paraqet kombinimin e plumbit, ndezësit, mbushësit dhe të gëzhgojës në një njësi të vetme.

Gjithashtu, duhet theksuar se jo vetëm sendet apo veglat e caktuara që nën presionin e gazrave, të cilat lirohen gjatë djegies së materieve shpërthyes, elektrike, gazrave nën presion ose energjisë tjetër potenciale hedhin predha në formë të një plumbi të vetëm konsiderohen armë, por edhe ato sende apo vegla që hedhin grumbull prej saçmash, gaz, lëng, shigjetë apo përbërës të tjerë.

Bazuar në përkufizimin e lartcekur, armë konsiderohen, si sendet dhe veglat e lartcekura që krijohen dhe përdoren për të shkaktuar lëndime trupore ose dëm fizik, ashtu edhe mjetet e tilla që janë krijuar dhe përdoren për shkaktimin e dëmit psikologjik. Po ashtu, të tilla konsiderohen edhe sendet, qëllimi kryesor i të cilave është kryerja e sulmit fizik si ndaj njerëzve, ashtu edhe ndaj pasurisë. Me fjalë të tjera, në KPK është mishëruar një përkufizim tejet i zgjeruar i armëve, pasi që si të tilla konsiderohen të gjitha sendet apo veglat e specifikuar më lart.

Po ashtu, bazuar në dispozitën e lartcekur ligjore, armë konsiderohen edhe: municioni, pjesët dhe përbërësit e armëve, si dhe armët nukleare, biologjike dhe kimike.

Sipas KPK-së, armët janë të kategorizuara në dhjetë (10) grupe, në mënyrën si vijon: 1. armët e zjarrit; 2. armët e koleksionit; 3. armët pneumatike (ajrore);³⁴ 4. armët që përdoren për shpërndarjen e gazit irritues; 5. armët shpërthyes; 6. armët me shigjeta; 7. armët e ftohta; 8. armët për sinjalizim akustik dhe të dritës; 9. armët elektrohok;³⁵ dhe 10. armët me rrymë.

Ndërsa, sipas dispozitës së lartcekur ligjore të KPK-së, këto në vijim nuk konsiderohen armë për qëllime të këtij Kodi: 1. armët për qëllime industriale; 2. armët dekorative; 3. imitimi i armëve;³⁶ 4. armët e zjarrit të bëra të papërdorshme (deaktivizuara) në mënyrë permanente me aplikimin e procedurave teknike që garantohen nga organi kompetent ose që njihen nga organi kompetent;³⁷ dhe 5. fuzhnjat për peshkim nën ujë. Pra, përveç që është përcaktuar përkufizimi dhe kategorizimi i armëve, siç shihet me dispozitat e KPK-së është përcaktuar edhe se çfarë nuk konsiderohet armë.

34 Armë pneumatike është arma përmes së cilës hedhet predha me presion të ajrit apo gazrave të kompresuara. Këto ndahen në tri tipa sipas fuqisë së burimit të tyre: 1. Me Dyoksid Karboni (CO₂), armë me fuqi të cilat përdorin bomba me dyoksid karboni të kompresuar, 2. Me fuqi të spirales, të cilat përdorin spiralen për të kompresuar ajrin në dhomën e ajrit, dhe 3. Me pompim pneumatik me fuqi të levës e cila kompreson ajrin në dhomën e ajrit.

35 Armë me elektrohok konsiderohet arma e cila përdoret për paaftësim të përkohshëm të personit përmes elektrohokut që ka për qëllim pengimin e funksioneve të muskujve sipërfaqësorë.

36 Imitim i armës konsiderohet mjeti, dukja e jashtme e të cilit ngjason me atë të armës, por i cili nuk mund të përdoret si armë zjarri dhe nuk i përket kategorisë A, B, C dhe D.

37 Armë të çaktivizuara janë armët e kategorisë A, B, C dhe D, pjesët thelbësore të të cilave janë bërë në mënyrë të përhershme dhe të papërshtatshme për përdorim përmes çaktivizimit, duke siguruar se të gjitha pjesët thelbësore të armës janë bërë në mënyrë të përhershme jofunksionale dhe të pamundshme për t'u lëvizur, zhvendosur dhe për t'u modifikuar që do t'ia mundësonte armës për t'u riaktivizuar. Procedurat teknike dhe kërkesat e shënimit për çaktivizim duhet të vërtetohen nga organi kompetent.

Gjithashtu, përveç që është përcaktuar përkufizimi i armëve dhe kategorizimi i tyre, me dispozitat e KPK-së janë rregulluar dhe parashikuar edhe disa aspekte të tjera që kanë të bëjnë me armët. Në këtë drejtim, mund të veçohen këto aspekte të rëndësishme:

- **Së pari**, siç është përmendur edhe më parë, për dallim nga shumë kode të tjera penale bashkëkohore, KPK-ja i ka kushtuar një kapitull të veçantë veprave penale të armëve, i cili Kapitull është emërtuar “Veprat penale të armëve”- Kapitulli XXIX. Në këtë Kapitull janë parashikuar gjashtë (6) vepra penale të armëve, të cilat do të trajtohen dhe do të shtjellohen në vijim të këtij punimi;
- **Së dyti**, te disa vepra penale, posedimi i armës, përdorimi i armës ose kanosja për përdorimin e armës është parashikuar si element kualifikues i veprës penale përkatëse. Kështu, te vepra penale “Kanosja”, nga neni 181, paragrafi 2 i KPK-së, është parashikuar si element kualifikues i kësaj vepre penale kanosja për përdorimin e armës; te vepra penale “Grabitja”, nga neni 317, paragrafi 3 i KPK-së, është parashikuar si formë e kualifikuar e kësaj vepre penale nëse vepra penale është kryer nga kryesi i cili ka me vete armën; te vepra penale “Sulmi”, nga neni 184, paragrafi 2 të KPK-së, është parashikuar si formë e kualifikuar fakti që kjo vepër penale është kryer me përdorimin e armës.
- **Së treti**, përdorimi i disa armëve të caktuara në rrethana të caktuara është parashikuar si vepër penale e posaçme ose si veprim kryes i veprës penale të caktuar. Kështu, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve, eksplozivit, materialeve radioaktive ose armëve nukleare, biologjike ose kimike ndesh me nenet 170, 361 ose 364-369 të këtij Kodi ose përvetësimi i paautorizuar, mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose përdorimi i armëve, eksplozivit, materialeve radioaktive ose armëve nukleare, biologjike ose kimike, ose hulumtimet për ose ndërtimin e armëve biologjike ose kimike ndesh me nenet 170, 361 ose 364-369 të këtij Kodi, si dhe ndërmarrja e veprimeve tjera përkatëse me armë janë pjesë përbërëse të veprës penale të terrorizmit;³⁸ në nenin 138, paragrafi 3 të KPK-së është parashikuar se kushdo që dërgon apo bart në apo jashtë territorit të Kosovës armë, eksploziv, helme, pajisje, municion apo material tjetër për kryerjen e një apo më shumë veprave penale nga ky kapitull, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet; te krimet e luftës, veprimet e caktuara që ndërlidhen me armët janë të inkriminuara në mënyrë të veçantë (p.sh., “Përdorimi i mjeteve ose i metodave të ndaluara të luftimit”, nga neni 150 i KPK-së, etj.).
- **Së katërti**, në nenin 56, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11. të KPK-së është parashikuar si detyrim i veçantë me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht, edhe heqja dorë nga mbajtja e çfarëdo lloji të armëve.
- **Së pesti**, në disa raste, arma është parashikuar shprehimisht si mjet për kryerjen e veprës penale. Kështu, te vepra penale “Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm”, nga neni 356,

38 Neni 128, KPK.

paragrafi 1 të KPK-së është parashikuar shprehimisht arma si mjet i kryerjes së kësaj vepre penale.

3.5.2 Armët dhe kategorizimi i tyre sipas Ligjit për Armë

3.5.2.1 Shqyrtime të përgjithshme

Ngjashëm sikurse KPK, edhe në Ligjin për Armë është përcaktuar përkufizimi i armëve dhe kategorizimi i tyre. Mirëpo, për dallim nga KPK-ja, në Ligjin për Armë përveç përkufizimit të përgjithshëm të armëve, janë përcaktuar edhe përkufizimet specifike të armëve të caktuara, si dhe janë parashikuar disa kategorizime të veçanta të armëve.

Kështu, në nenin 2, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7. të Ligjit për Armë është përcaktuar se **“Armë”** konsiderohet secili mjet ose vegël e punuar me qëllim që nën presionin e gazrave të cilat shkaktohen gjatë djegies së materialeve shpërthyes, elektricitetit, gazrave nën presion ose energjisë tjetër potenciale, të hedhë predha, grumbullit prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose përbërësish të tjerë, që është e përcaktuar ose është përdorur për të shkakuar dëm trupor, dëm fizik, dëm psikologjik dhe po ashtu çdo mjet tjetër qëllimi i të cilit është të bëjë sulm fizik ndaj integritetit fizik të njerëzve ose pronës.³⁹

3.5.2.2 Kategorizimi i armëve

Sipas Ligjit për Armë, armë konsiderohen: 1. armët e zjarrit; 2. armët e koleksionit; 3. armët pneumatike; 4. armët për përdorim të agentëve kimikë; 5. armët eksplozive (shpërthyes); 6. armët me hark, tojë (tetivë); 7. armët e ftohta; 8. armët për sinjalizim me dritë dhe akustik; 9. armët me elektroshok (paralizuesit elektrikë); dhe 10. armët e drejtuara me energji (ADE).⁴⁰

Gjithashtu, armë konsiderohen edhe: **a) municioni, b) adaptuesit dhe c) pjesët thelbësore të armëve**, përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.⁴¹

39 Në nenin 3 të Ligjit nr.74/2014 “Për armët” të Republikës së Shqipërisë, datë 10.07.2014, është parashikuar se “Armë” konsiderohet çdo mjet ose vegël e përgatitur me qëllim që, nën presionin e gazrave, të cilat shkaktohen gjatë djegies së lëndëve shpërthyes, elektricitetit, gazrave, të hedhë predha në formë plumbi, grumbulli prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete që shkaktojnë dëm fizik a psikologjik.

40 Neni 3, paragrafi 1, Ligji për Armë.

41 Neni 3, paragrafi 2, Ligji për Armë.

- (a) **Municioni** përfshin fishekët,⁴² diabolat⁴³ dhe predhat e tjera së bashku me fitilat dhe mbushësit e tyre;⁴⁴
- (b) **Adaptuesi** është pajisje mekanike që vendoset në tytë apo në fole në mënyrë që të ndërrojë tipin e tytës apo kalibrin,⁴⁵ kurse
- (c) **Pjesët thelbësore të armës së zjarrit** përfshijnë pjesët e ndara të armës së zjarrit si: mekanizmin mbyllës të folesë, folenë dhe tytën e armës së zjarrit që janë të përfshira në kategorinë e armës së zjarrit në të cilën montohen ato.⁴⁶

Duke u bazuar në nenin 4 të Ligjit për Armë, armët kategorizohen në katër (4) grupe:

Kategoria A;

Kategoria B;

Kategoria C;

Kategoria D.

Kategoria A - përfshin armët e zjarrit të ndaluara për civilë si përdorues të fundit, të cilat janë: 1. predhat ushtarake plasëse dhe sistemet për lansim (A1); 2. armë zjarri automatike (A2); 3. armë zjarri të kamufluara në formë të një mjeti tjetër (A3); 4. municion me shkallë të lartë depërtuese, municioni me predha shpërthyes, municioni me predha ndezëse, si dhe predhat për municion të tillë dhe municion me predha gome për menaxhim të turmave (A4); 5. municioni me predhë shpërndarëse dhe hapëse, si dhe predhat për municion të tillë, përveç në rastet e armëve për gjah apo për shenjëtari të personave që kanë të drejtë t'i përdorin ato (A5); 6. armë zjarri me zhurmëmbytës të montuar (A6); 7. armë zjarri me tytë të vjaskuar me kalibër mbi 12.7 milimetra (A7); 8. mjetet plasëse dhe pjesët e tyre (A8); 9. armë për përdorim të agentëve kimikë dhe municioni i saj (A9); 10. pajisja e veçantë për armë zjarri e cila mundëson ndryshimin e armës së zjarrit në kategori tjetër nga ajo origjinalja (A10); 11. armë me elektroshok (paralizues elektrikë) (A11); 12. municioni gjurmëlënës (A12); 13. municioni me veprim të dyfishtë (A13); 14. municioni me kapacitet depërtues në pajisjet mbrojtëse antiplumb (A14); 15. armë e drejtuar me energji ADE (A15); dhe 16. armë zjarri me tytë poligonale (A16).⁴⁷

42 Fisheku është njësi e municionit për armën e zjarrit e cila paraqet kombinimin e ndezësit, mbushësit, gëzhgjës dhe predhës në një njësi të vetme.

43 Diabolja është predhë jo sferike e paraparë për qitje nga arma pneumatike, ndryshe i njohur si "plumb i pushkës ajrore".

44 Neni 2, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.41., Ligji për Armë.

45 Neni 2, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.39., Ligji për Armë.

46 Neni 2, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.35., Ligji për Armë.

47 Neni 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., Ligji për Armë.

Kategoria B - përfshin armët për të cilat kërkohet leja, të cilat janë: 1. armë e shkurtër zjarri gjysmë-automatike apo përsëritëse (B1); 2. armë e shkurtër zjarri për një qitje, me ndezje qendrore (B2); 3. armë e shkurtër zjarri me ndezje anësore për një qitje, me gjatësi të përgjithshme më të vogël se 28 cm (B3); 4. armë zjarri të gjata gjysmë-automatike me arkëz dhe fole për fishekë së bashku që mund të mbajnë më tepër se tre (3) fishekë (B4); 5. armë zjarri të gjata gjysmë-automatike me arkëz dhe fole për fishekë që së bashku mund të pranojnë deri në tre (3) fishekë dhe mbushësi i të cilave ndërrohet, apo kur nuk është e sigurt që kjo armë nuk mund të konvertohet me ndihmën e veglës së rëndomtë, me ç'rast arkëzat e fishekëve mund të pranojnë më tepër se tre (3) fishekë (B5); 6. armë zjarri e gjatë gjysmë-automatike ose me përsëritje, me tytë të pavjaskuar të gjatë deri më 60 cm (B6).⁴⁸

Kategoria C - përfshin armët me cilësi teknike të kufizuara për të cilat kërkohet leja e të cilat janë: 1. armë zjarri e gjatë me përsëritje që nuk është përfshirë në pikën 6 të kategorisë B (C1); 2. armë zjarri e gjatë me një gjuajtje me tytë të vjaskuar (C2); 3. armë zjarri e gjatë gjysmë-automatike, që nuk është përfshirë në pikat 4, 5. dhe 6 të kategorisë B (C3); 4. armë zjarri e shkurtër me një qitje me goditje anësore gjatësia e përgjithshme e së cilës nuk është më e vogël se 28 cm (C4); 5. armë zjarri e gjatë me një qitje, me tytë të pavjaskuar (C5); 6. armë pneumatike me energji në grykën e armës mbi 7.5 J dhe me kalibër mbi 4.5 mm (C6); 7. armë zjarri për sinjalizim me dritë dhe akustikë (C7); 8. armë dhe municion për pasivizim të përkohshëm të kafshëve (C8); dhe 9. adaptues (C9).⁴⁹

Kategoria D - përfshin armët që duhet të lajmërohen dhe për të cilat lëshohet leje e të cilat janë: 1. armët e zjarrit antike (D1); 2. armë pneumatike me energji në grykën e armës deri në 7.5 J dhe me kalibër deri në 4.5 mm (D2); 3. armët me hark, tojë apo tetivë (D3); dhe 4. armët e ftohta (D4).⁵⁰

Në fund, duhet theksuar se sikurse në KPK, edhe në Ligjin për Armë është parashikuar se **armë sipas këtij ligji nuk konsiderohen**: 1. armët për qëllime industriale;⁵¹ 2. armët dekorative;⁵² 3. imitimet e armëve; 4. armët të cilat janë bërë të papërdorshme (të çaktivizuara) në mënyrë të përhershme, përmes zbatimit të procedurave teknike të cilat janë të përcaktuara nga organi kompetent dhe 5. harpunët për peshkim nën ujë.⁵³

48 Neni 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2., Ligji për Armë.

49 Neni 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3., Ligji për Armë.

50 Neni 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4., Ligji për Armë.

51 Armë për qëllime industriale është arma e prodhuar për therje të kafshëve apo për peshkim me harpun, për qëllime industriale ose teknike me kusht që ato të përdoren vetëm për qëllimin e lartcekur.

52 Armë dekorative është mjete i prodhuar për qëllime dekorative, i cili nuk mund të përdoret si armë.

53 Neni 3, paragrafi 3, Ligji për Armë.

3.5.3 Armët e zjarrit dhe kategorizimi i tyre

3.5.3.1 Shqyrtime të përgjithshme

Armët e zjarrit janë një nocion më i ngushtë se armët në përgjithësi. Sipas nenit 2, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.8., të Ligjit për Armë, **“Armë e zjarrit”** konsiderohet çdo armë e bartshme me tytë që hedh, e cila është e projektuar për të hedhur apo mund të jetë e konvertuar për të hedhur predhë, saçmë⁵⁴ apo diabolë nga veprimi i një shtytësi të djegshëm.

Duke u bazuar në këtë përkufizim ligjor, arma e zjarrit ka këto karakteristika:

- (a) **është armë e bartshme;**
- (b) **është armë me tytë;**
- (c) **është armë që hedh, apo është e projektuar për të hedhur apo mund të jetë e konvertuar për të hedhur predhë, saçmë apo diabolë nga veprimi i një shtytësi të djegshëm.**

Kurse, objekti konsiderohet si i aftë për t’u konvertuar, nëse plotëson kushtet si në vijim: ka pamjen e armës së zjarrit ose si rezultat i konstruksionit apo për shkak të strukturës së materialit, mund të konvertohet në armë zjarri.

Ndërsa, me dispozitat ligjore të Ligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore të sigurisë, është parashikuar një përkufizim më ndryshe i armëve të zjarrit. Kështu, në nenin 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4., të këtij Ligji, është parashikuar se **“Armë e zjarrit”** është pajisja që mund të përdoret si armë e cila gjuan një predhë të vetme ose shumë predha me shpejtësi të madhe përmes shtytjes së gazrave që krijohen nga djegia e shpejtë e brendshme e lëndës shtytëse ose përmes formave tjera të shtytjes së predhës që shkrepet nga arma e zjarrit.⁵⁵

3.5.3.2 Kategorizimi i armëve të zjarrit

Varësisht se cili kriter merret për bazë, armët e zjarrit mund të kategorizohen në disa grupe.

Kështu, nëse merret për bazë gjatësia, arma e zjarrit mund të jetë:

⁵⁴ Saçme janë numri i madh i predhave të vogla, qëllimi i të cilave është shkrepetja e përnjëhershme me një të shtënë të vetme, kurse armët që mund të mbahen me dorë të prodhuara për këtë lloj të municionit janë kryesisht të njohura si pushkë gjuetie.

⁵⁵ Në nenin 3 të Ligjit nr. 74/2014 “Për armët” të Republikës së Shqipërisë, datë 10.07.2014, është parashikuar se “Armë zjarri” është çdo armë e transportueshme me tytë që realizon, është e projektuar për të realizuar ose mund të modifikohet lehtësisht për të realizuar të shtëna, plumba ose predha me anë të një lënde plasëse. Kurse, në nenin 5, paragrafi 6 të Ligjit për Armët të Republikës së Kroacisë, datë 01.06.2007, është parashikuar se “Armë zjarri” konsiderohen të gjitha llojet e mjeteve apo pajisjeve me të cilat mund të realizohen gjuajtje të një kokrrë, topi, shigjete ose predhe tjetër përmes tytës nga veprimi i shtypur i gazrave të barutit.

(a) Armë e shkurtër e zjarrit apo**(b) Armë e gjatë e zjarrit.**

Armë e shkurtër e zjarrit konsiderohet arma e zjarrit me tytë e cila nuk kalon gjatësinë prej tridhjetë centimetra (30 cm) apo gjatësia e gjithmbarshme e së cilës nuk kalon gjashtëdhjetë (60 cm), kurse armë e gjatë e zjarrit konsiderohet çdo armë e zjarrit, duke përjashtuar armët e shkurtra të zjarrit.⁵⁶ Pra, çdo armë e zjarrit që nuk është e shkurtër, konsiderohet armë e gjatë e zjarrit.

Nëse merret për bazë se a ka arma e zjarrit vjaska apo jo, arma e zjarrit mund të jetë:

(a) Armë e zjarrit me vjaska apo**(b) Armë e zjarrit pa vjaska.**

Armë e zjarrit me vjaska konsiderohet arma e zjarrit, tyta e së cilës është e kanalizuar nga ana e brendshme e cila gjatë qitjes ka ndikim në shpejtësinë dhe drejtimin e predhës, kurse armë e zjarrit pa vjaska konsiderohet arma e zjarrit e cila nuk është armë e zjarrit me vjaska.⁵⁷ Vjaskat e armës së zjarrit nënkuptojnë vijat e thella në trajtë spiraleje brenda tytës së armës së zjarrit, që shërbejnë për t'i dhënë predhës lëvizje dhe shpejtësinë rrotulluese.

Nëse merret për bazë kriteri se sa fishekë mund të shkrepën me një tërheqje të këmbëzës, armët e zjarrit ndahen në:

(a) Armë automatike të zjarrit dhe**(b) Armë gjysmë-automatike të zjarrit.**

Armë automatike e zjarrit konsiderohet arma e zjarrit e cila mbushet automatikisht sa herë që shkrepet fisheku dhe e cila mund të shkrepë më shumë se një fishek me një tërheqje të këmbëzës, kurse armë gjysmë-automatike e zjarrit konsiderohet arma e zjarrit që rimbushet në mënyrë automatike sa herë që shkrepet fisheku dhe e cila mund të shkrepë vetëm një fishek me një tërheqje të këmbëzës.⁵⁸

3.5.3.3 Kategoritë e veçanta të armëve të zjarrit

Përveç armëve të paraqitura më lart, në Ligjin për Armë janë parashikuar edhe disa kategori të veçanta të armëve të zjarrit. Në këtë mënyrë, vlen të përmenden edhe këto kategori të veçanta të armëve:

⁵⁶ Neni 2, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.9., dhe 1.10., Ligji për Armë.

⁵⁷ Neni 2, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.11., dhe 1.12., Ligji për Armë.

⁵⁸ Neni 2, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.13., dhe 1.14., Ligji për Armë.

Armët e zjarrit përsëritëse që përfshijnë armën e zjarrit e cila pas shkrepjes së fishekut është e paraparë për t'u rimbushur me dorë nga karikatori apo nga cilindri.

Armët e zjarrit me qitje një nga një që përfshijnë armën e zjarrit pa karikator e cila mbushet përmes futjes me dorë të fishekut në fole apo në prerjen e tytës për mbushje para çdo shkrepje.

Armët e zjarrit për sinjalizim me dritë dhe akustikë që përfshijnë armën e zjarrit që përdoret si sinjal për ndonjë fatkeqësi, si dhe për qëllime të tjera sinjalizuese në det, në mes të fluturakeve dhe njerëzve në tokë, duke përfshirë të gjitha llojet e armëve dhe mjeteve të tjera të cilat nën shtypjen e barutit apo të gazrave shkrepin apo hedhin të shtëna sinjalizuese në një drejtim dhe zbrazin apo shkapërderdhin predha, me përjashtim të pistoletave ndriçuese për përdorim ushtarak. Sinjalizimi me akustikë përdoret nga arma qorre që nënkupton se kjo armë nuk hedh predhë.

Armët eksplozive që përfshijnë çdo lloj të bombës, minës, raketës, granatës apo mjetit tjetër që përmban substanca eksplozive apo materiale ndezëse, ndaj të cilave për shkak të proceseve të brendshme apo të jashtme (peshës, ndikimit, fërkitimit, reagimit kimik, energjisë elektrike dhe të ngjashme) shkaktohet liri apo krijimi i energjisë dhe eksplodimit. Armët eksplozive gjithashtu konsiderohen pjesët e eksplozivëve, detonatorët, mjetet piroteknike apo pjesët e tjera për të cilat qartë duket se janë të parapara për përgatitjen e armëve eksplozive. Ky përkufizim është i paraparë të përfshijë armët termobarike të cilat dallohen nga armët konvencionale eksplozive për shkak se funksionojnë me oksigjen atmosferik dhe nuk kanë oksidues në eksplozivët e tyre. Armët termobarike po ashtu quhen armë termobarike me impuls të lartë (TIL), eksploziv karburant-ajër (EKA apo FAX), si dhe nganjëherë quhen edhe municione karburant-ajër, armë me nxehtësi dhe shtypje apo bomba vakumike.

Armët e kombinuara të zjarrit që konsiderohen armët e zjarrit me më shumë tyta, kur kombinimi i tytave bëhet prej tytave ose kalibrave të ndryshëm në të njëjtën armë;

Armët e gjahut që përfshijnë armët e prodhuara apo kryesisht të përdorura për gjah të kafshëve në përputhje me legjislacionin për gjahun e cilat dallohet nga ato të kategorisë A apo nga armët që kryesisht përdoren për qëllime luftarake dhe të cilat i përkasin kategorisë B, C dhe D; dhe

Armët antike të zjarrit që përfshijnë të gjitha armët e zjarrit të prodhuara para vitit 1899 që ndizen me shkrepës, gur stralli apo me kapsollë ose me sistem të ngjashëm të ndezjes. Riprodhimi i armës antike të zjarrit përfshin kopjen e armës së zjarrit antike, mekanizmi shkrepës i së cilës është modifikuar përmes teknologjisë moderne;

3.5.3.4 Pjesët përbërëse të armëve të zjarrit sipas Ligjit për Armë

Në Ligjin për Armë janë të parashikuara edhe pjesët përbërëse të armëve të zjarrit. Në këtë aspekt, vlen të përmendet se **“pjesë të armës së zjarrit”** do të thotë çdo element apo

zëvendësim, por duke mos u kufizuar, që është e dizajnuar në mënyrë specifike për armë të zjarrit dhe është thelbësore për funksionimin e saj, duke përfshirë **tytën, kornizën ose pranuesin, kafkën ose cilindrin, mekanizmin mbyllës të folesë, gjilpërën goditëse dhe çdo mjet tjetër i dizajnuar ose përshtatur për të zvogëluar zhurmën e shkaktuar nga qitja e armës së zjarrit.**

Kurse, **“pjesët thelbësore të armës së zjarrit”** përfshijnë pjesët e ndara të armës së zjarrit si: **mekanizmin mbyllës të folesë, folenë dhe tytën e armës së zjarrit** që janë të përfshira në kategorinë e armës së zjarrit në të cilën montohen ato.

Ndërsa, **“pajisje e veçantë për armë të zjarrit”** është çdo mekanizëm që është i prodhuar dhe i dedikuar për rritjen e performancës dhe cilësisë së përdorimit të armës së zjarrit, përveç shënjestrës optike.

Tjetër pjesë e rëndësishme e armës së zjarrit që përmendet në Ligjin për Armë është edhe **“zhurmëmbytësi”** që është pajisje që i bashkëngjitet apo është pjesë e tytës së armës së zjarrit me qëllim të zvogëlimit të zhurmës dhe flakës së krijuar nga qitja me armë zjarri.

Po ashtu, duhet përmendur edhe **“shënjestrën optike”** që është një pajisje për armë që është e prodhuar si mjet ndihmës për shënjestrim apo mjet optik që përdoret si mjet ndihmës në caktimin e shënjestrës.

Si dhe **“adaptuesi”** që është një pajisje mekanike që vendoset në tytë apo në fole në mënyrë që të ndërrojë tipin e tytës apo kalibrin.

3.5.4 Leja për lëvizje me armë

Një çështje tejet e rëndësishme që është rregulluar me Ligjin për Armë është domosdoshmëria e posedimit të lejes për lëvizje me armë, që mund t'i lëshohet personit juridik dhe personit fizik.

Shpeshherë në praktikën gjyqësore të pandehurit janë shpallur fajtorë për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366, paragrafi 1 i KPK-së, për faktin se të njëjtit edhe pse kanë poseduar leje për mbajtjen e armës, ata nuk kanë poseduar leje për lëvizje me armë. Pra, leja për lëvizje me armë është një leje e posaçme që mund t'i lëshohet personit juridik dhe personit fizik për të lëvizur me armë nga një vend në një vend tjetër.

Leja për lëvizje me armë është një dokument që i lëshohet personit juridik dhe personit fizik nga organi kompetent i përcaktuar me Ligjin për Armë, me të cilën personit juridik i njihet e drejta e lëvizjes nga depoja në vendin për gjah, shenjëtari ose në vendin për riparim dhe transport për armët e koleksionit të lejuara ose për ekspozitë, kurse për personin fizik, me leje të lëshuara për armë i njihet e drejta për lëvizjen nga vendbanimi i personit fizik në

vendin për gjah ose shenjëtari ose në vendin për riparim dhe transport të armëve të koleksionit për ekspozitë.⁵⁹

Organ kompetent për lëshimin e lejes për lëvizje me armë është Policia e Kosovës, Stacioni Policor në vendbanimin e personit që e kërkon një leje të tillë.

Kjo leje për lëvizje me armë, përveç tjerash mund t'i lëshohet personit fizik që posedon këto lloje të lejeve: leje për armë gjahu;⁶⁰ leje për armë shenjëtarie;⁶¹ leje për armë të Kategorisë D;⁶² etj.

Përveç me dispozitat ligjore të Ligjit për Armë, procedurat e lartcekura janë të rregulluara në mënyrë specifike edhe me aktet tjera nën-ligjore të Ministrisë së Punëve të Brendshme.⁶³ Shumë çështje që kanë të bëjnë me armët e zjarrit janë të rregulluara edhe me një sërë aktesh nën-ligjore në formën e udhëzimeve, rregulloreve të ndryshme, etj. Në këtë mënyrë, në ueb-sajtin e Ministrisë së Punëve të Brendshme gjenden disa udhëzime administrative dhe akte të tjera juridike me të cilat rregullohen çështje të ndryshme që ndërlidhen me armët e zjarrit.⁶⁴

3.6 Domosdoshmëria e harmonizimit të legjislacionit vendor në raport me trendet bashkëkohore në fushën e armëve të zjarrit

Është e rëndësishme të theksohet se pavarësisht ndryshimeve që janë bërë kohët e fundit, si në Ligjin për Armë, ashtu edhe në KPK, megjithatë vlerësohet e nevojshme që legjislacioni ynë të harmonizohet edhe me trendet bashkëkohore në fushën e armëve të zjarrit, në veçanti prodhimit të formave të reja të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre dhe municionit.

59 Neni 2, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6., Ligji për Armë.

60 Neni 21, Ligji për Armë.

61 Neni 22, Ligji për Armë.

62 Neni 23, Ligji për Armë.

63 Maliqi, Agim; Shala, Afrim, *Përmbledhje me raste nga praktika gjyqësore lidhur me armët e zjarrit, Vëllimi 1* | 2020-2024, E drejta penale dhe praktika gjyqësore në Kosovë, Prishtinë, 2024, f. 14. Udhëzime Administrative më të rëndësishme që kanë të bëjnë me armët e zjarrit mund të konsiderohen: Udhëzimi Administrativ nr. 25/2010 - MPB për Gjurmimin e Armëve të Zjarrit, Pjesëve të tyre dhe Municionit; Udhëzimi Administrativ nr. 26/2010 - MPB për Shënjimin e Armëve të Zjarrit, Pjesëve dhe Municionit të tyre; Udhëzimi Administrativ nr. 15/2010 - MPB për Legalizimin e Armëve të Zjarrit që i takojnë Kategorisë B, C dhe D1; Udhëzimi Administrativ nr. 08/2023 - MPB për Objektet dhe Procesin Teknologjik të Prodhimit të Armëve, Pjesëve të Armëve dhe Municionit; Udhëzimi Administrativ nr. 03/2016 - MPB për Leje për Lëvizje me Armë; Udhëzimi Administrativ nr. 24/2010 - MPB për Procedurat e Trashëgimisë për Armë dhe Municion në rast të Vdekjes së Pronarit të Armës së Zjarrit; Udhëzimi Administrativ nr. 08/2016 - MPB për Kushtet Minimale Teknike për Ruajtjen e Armës, Pjesëve të Armës dhe Municionit, etj.

64 <https://mpb.rks-gov.net/f/35/Udhezime-administrative>

E gjithë kjo si rezultat i ndikimit të teknologjive të reja, sidomos në vendet e zhvilluara, por jo vetëm, duke përfshirë këtu edhe prodhimin dhe zhvillimet lidhur me: **“armët inteligjente” (“Smart Guns”); “Printimin tredimensional (3D) të armëve të zjarrit”; “armët e pagjurmueshme” (“Ghost guns”);** përdorimin e kodit QR;⁶⁵ përdorimin e identifikimit të radio-frekuencës (“RFID”),⁶⁶ etj.

Në këtë drejtim, në legjislacionin tonë nuk janë të njohura dhe të parashikuara shprehimisht të ashtuquajturat **“armë inteligjente” (“Smart Guns”),**⁶⁷ të cilat janë të projektuara që të shkrepin vetëm nga dora e pronarit të armës. Armët e tilla, të cilat tani më janë në shitje në tregun e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, konsiderohen armë të personalizuar që mund të shkrepin vetëm nga përdoruesit e verifikuar, gjë që mundësohet nga teknologjia e njohjes së fytyrës apo/dhe shenjave të gishtave.

Armët e tilla inteligjente posedojnë një sensor që bën identifikimin e fytyrës së përdoruesit dhe gjithashtu janë të pajisura edhe me një sensor të këmbëza përmes të cilit bëhet identifikimi i shenjave të gishtave. Nëse arma nuk e identifikon pronarin e saj, ajo nuk shkrep, që do të thotë se ajo bëhet jo-funksionale, pasi të njëjtën nuk mund ta përdorin personat e tretë, të paautorizuar.

Përveç armëve inteligjente, duhet sa më parë të jetë e mundur të shqyrtohet mundësia e rregullimit ligjor edhe të metodave të reja të prodhimit të armëve, përmes të të ashtuquajturit **“Printim tredimensional (3D) të armëve të zjarrit”.** Printimi tredimensional (3D) është një teknologji nëpërmjet së cilës shtresa të njëpasnjëshme të materialit shtrohen njëra mbi tjetrën nën kontrollin e kompjuterit dhe rezultati final është një objekt tredimensional.⁶⁸ Kohët e fundit, “Printimi 3D” njihet edhe si një metodë relativisht e lehtë për të prodhuar armët e zjarrit,⁶⁹ duke shtuar kështu shqetësimet se kjo mund të rrisë përhapjen e tyre, pasigurinë dhe terrorizmin.

Në vitin 2014, një i ri nga Japonia u bë personi i parë në botë që u arrestua për shkak se kishte prodhuar armë zjarri nëpërmjet printimit 3D. Arsyeja e arrestimit ishte mbajtja e armëve të

65 Përdorimi i kodit QR në armë mund të sigurojë qasje në numrat e serisë së armës së zjarrit, në të dhënat e prodhimit dhe certifikatat e sigurisë, duke përmirësuar gjurmueshmërinë dhe pajtueshmërinë.

66 RFID është përdorimi me valë i fushave elektromagnetike të radio-frekuencës për të transferuar të dhëna për qëllime të identifikimit dhe gjurmimit automatik të etiketave të bashkëngjitura në objekte. Teknologjitë e shenjave të bazuara në RFID, krijojnë një kanal komunikimi midis armës së zjarrit dhe tokenit që më pas çaktivizon një mekanizëm bllokues. Në këtë mënyrë, vetëm përdoruesi i autorizuar mund të përdorë armën e zjarrit, pasi që një pajisje vendoset në dorezën e armës, ndërsa një pajisje tjetër vendoset në një orë, unazë ose byzylyk, ose madje futet në dorën e një përdoruesi të autorizuar, kurse nëse të dy pajisjet nuk janë brenda centimetrave nga njëra-tjetra, këmbëza nuk do të zhbllokohet dhe mekanizmi nuk lirohet.

67 <https://smartgun.com/>

68 <https://www.thetrace.org/2021/02/3d-printer-ghost-gun-legal-liberator-deterrence-dispensed/> dhe gjithashtu, kliko në: https://en.wikipedia.org/wiki/3D_printed_firearm

69 “How to Make a Gun at Home”, The Wall Street Journal, <https://www.wsj.com/articles/how-to-make-a-gun-at-home-1477610554>

printuara me teknikën 3D në kundërshtim me ligjin “Për kontrollin e armëve të zjarrit dhe shpatave”. Ai vendosi në internet skema dhe udhëzime me video për prodhimin e një arme, dhe për pasojë u dënua me dy vjet burgim. Policia gjeti në shtëpinë e tij të paktën dy armë të tilla që mund të shkrepnin plumba.⁷⁰

Duke qenë se konsumatorët tani e kanë më të lehtë të gjejnë printerë të tillë, përdorimi i tyre për prodhimin e armëve të zjarrit mund të rritet, ndërsa ky zhvillim ngërthen në vete një sërë sfidash, duke përfshirë sfidat për kontrollin e prodhimit të palicencuar, duke vendosur kufizime për skedarët digjitalë që lidhen me armët e zjarrit në internet, sfidën e gjurmueshmërisë së armëve të zjarrit të printuara me teknikën 3D, etj.

Andaj, edhe bazuar në rrezikun që mund të paraqesin për shoqërinë, është e nevojshme që në legjislacionin tonë të inkriminohen si vepra penale të veçanta: “Posedimi, postimi në internet apo çdo formë tjetër e shpërndarjes së të dhënave teknike që mund të përdoren për prodhimin e armëve të zjarrit dhe pjesëve të tyre përmes printimit 3D”, si dhe “Posedimi, blerja, shitja, shfrytëzimi dhe veprimet tjera të paligjshme të armëve të tilla dhe pjesëve të tyre të prodhuara përmes printimit 3D”.

Gjithashtu, duhet përmendur edhe të ashtuquajturat “**armë të pagjurmueshme**” apo “**Ghost Guns**”, të cilat janë armë zjarri që krijohen nga komponentë të ndryshëm dhe të veçantë, të cilat pastaj bëhen plotësisht funksionale dhe vdekjeprurëse. Këto janë armë që mund të prodhohen nga kushdo, pra janë armë të prodhuara në mënyrë private, duke përdorur pajisje dhe pjesë të veçanta.

70 Kokolj, Mirko: *Diskutim për printimin 3D dhe armët e zjarrit*, SEECAC, 2016, fq.3.

4. Disa dokumente të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e armëve të zjarrit

4.1 Shqyrtime të përgjithshme

Çështjet e armëve dhe kontrabanda e tyre kanë qenë dhe mbeten, përveç tjerash edhe problem global, ndërsa marrja me këtë aktivitet të jashtëligjshëm konsiderohet edhe formë e krimit të organizuar, e cila po sjell fitime të mëdha për organizatat kriminale të shoqërisë bashkëkohore.⁷¹

Sipas disa të dhënave të publikuara, vlerësohet se aktualisht në botë ekzistojnë 875 milionë armë të vogla, pjesa më e madhe e të cilave, 650 milionë sosh, janë në pronësi të popullsisë civile. Ndërsa, nga ky numër i armëve në pronësi të qytetarëve, vlerësohet se grupet kriminale (bandat) posedojnë 2-10 milionë armë.⁷²

Kontrabanda me armë, municion luftarak dhe materiale nukleare konsiderohet veprimtari ilegale mjaft fitimprurës për organizatat kriminale të shoqërisë bashkëkohore. Sipas të dhënave të publikuara të kësaj fushe, vlerësohet se kjo formë e krimit të organizuar gjeneron fitime të mëdha vjetore, duke u renditur në vendin e dytë për nga fitimet që sjell, menjëherë pas kontrabandës me narkotikë. Kësisoj, sipas të dhënave të publikuara vetëm kontrabanda e armëve të vogla dhe të lehta është vlerësuar të jetë në vlerë prej 1.7 deri në 3.5 miliardë dollar për çdo vit, e që është ekuivalente me 10-20% të tregtisë së ligjshme të armëve të vogla.⁷³

Duke qenë se po konsiderohej problem global, çështja e armëve është trajtuar edhe nga shumë organizata të ndryshme ndërkombëtare. Ka një sërë dokumentesh juridike ndërkombëtare të cilat rregullojnë çështje të ndryshme lidhur me armët e zjarrit, si në nivel të Organ-

71 Gashi, Rexhep: *Krimi i organizuar*, Prishtinë, 2023, fq.205.

72 H.S. Kassab, J.D. Rosen, *Illicit Markets, Organized Crime, and Global Security*, 2019, fq.137.

73 Latifi, Vesel; Demolli, Haki, *Kriminalistika - zbulimi dhe të provuarit e krimit*, Prishtinë, 2019, fq.379-380.

izatës së Kombeve të Bashkuara, ashtu edhe në kuadër të organizatave të ndryshme kontinentale dhe rajonale.⁷⁴

Në këtë drejtim, në kuadër të BE-së duhet të përmendet Rregullorja (BE) nr. 258/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14.03.2012,⁷⁵ që implementon nenin 10 të Protokollit të Kombeve të Bashkuara kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional (Protokolli i Kombeve të Bashkuara për Armët e Zjarrit) dhe përcakton autorizimet për eksportin dhe importin, si dhe masat për kalimin transit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve. Gjithashtu, është e rëndësishme të përmendet edhe Direktiva e Këshillit 91/477/KEE⁷⁶ për kontrollin e blerjes dhe posedimit të armëve të zjarrit, e ndryshuar me Direktivën 2008/51/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21.05.2008 dhe 2017/853, datë 17.05.2017. Më pastaj, duhet përmendur edhe Direktivën (EU) 2021/555 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 24.03.2021 për kontrollin e blerjes dhe posedimit të armëve, e cila do të prezantohet në vijim të këtij punimi.⁷⁷

Në nivel të Këshillit të Evropës, dokument i rëndësishëm në lidhje me armët e zjarrit konsiderohet Konventa Evropiane për Kontrollin e Blerjes dhe Posedimit të Armëve të Zjarrit nga Individët, datë 28.06.1978.⁷⁸

Ndërsa, në nivel të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për sa i përket çështjes së armëve të zjarrit, dokument i rëndësishëm konsiderohet Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional,⁷⁹ e miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, nr. 55/25, datë 15.11.2000. Ky dokument paraqet instrumentin bazë me karakter ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar transnacional. Së bashku me Konventën u miratuan edhe tre (3) protokolle që lidhen me fusha të caktuara të krimit të organizuar transnacional, duke përfshirë Protokollin e Kombeve të Bashkuara kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve.⁸⁰

74 Maliqi, Agim; Shala, Afrim, *Përmbledhje me raste nga praktika gjyqësore lidhur me armët e zjarrit*, f. 12.

75 <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2012/258/oj>

76 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/ALL/?uri=CELEX%3A31991L0477>

77 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32021L0555>

78 <https://rm.coe.int/1680077d97>

79 https://treaties.un.org/pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XVIII-12&chapter=18&clang=en

80 https://treaties.un.org/doc/source/recenttexts/18-12_c_e.pdf

4.2 Protokolli kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit

Protokolli kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit (**“Protokolli i Armëve të Zjarrit”**) është i vetmi instrument ligjërish i detyrueshëm për të luftuar prodhimin e paligjshëm dhe trafikimin e armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit në nivel global. Ky Protokoll u miratua me Rezolutën 55/255, datë 31.05.2001, në sesionin e 55-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe hyri në fuqi më 03.07.2005. Protokolli i Armëve të Zjarrit plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional (**“Konventa kundër Krimit të Organizuar”**) dhe së bashku me Protokollin për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve dhe Protokollin kundër kontrabandës së migrantëve me rrugë tokësore, detare dhe ajrore, përfaqëson angazhimin e komunitetit ndërkombëtar për të luftuar krimin e organizuar transnacional.⁸¹

Protokolli i Armëve të Zjarrit parashikon një kornizë për shtetet për të kontrolluar dhe rregulluar flukset e ligjshme të armëve, për të parandaluar devijimin e tyre në qarkun e paligjshëm, për të lehtësuar hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale të natyrës së tillë.

Gjithashtu, Protokolli i Armëve të Zjarrit synon promovimin dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zhvillimin e mekanizmave kohezivë për të parandaluar, luftuar dhe çrënjosur prodhimin e paligjshëm dhe trafikimin e armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit. Duke ratifikuar ose aderuar në Protokollin e Armëve të Zjarrit, shtetet angazhohen për të miratuar dhe zbatuar një sërë masash për kontrollin e krimit me qëllim:

- (a) përcaktimin si vepër penale të prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit në përputhje me kërkesat dhe përkufizimet e Protokollit;
- (b) adoptimin e masave efektive të kontrollit dhe të sigurisë, duke përfshirë asgjësimin e armëve të zjarrit, me qëllim të parandalimit të vjedhjes dhe devijimit të tyre në qarkun e paligjshëm;
- (c) krijimin e një sistemi autorizimesh ose sistemi licencimi qeveritar që synon të sigurojë prodhimin dhe trafikimin legjitim të armëve të zjarrit dhe
- (d) sigurimin e shënimit, regjistrimit dhe gjurmimit adekuat të armëve të zjarrit, si dhe bashkëpunim efektiv ndërkombëtar për këtë qëllim.

Miratimi i këtij Protokolli ka një rëndësi të madhe në fushën e parandalimit dhe luftimit të prodhimit të paligjshëm të armëve dhe municionit, e veçmas të armëve të brezit dhe të armëve

81 <https://www.unodc.org/unodc/en/firearms-protocol/the-firearms-protocol.html>

të lehta. Kjo edhe nga fakti se, siç dihet, në ditët e sotme qarkullojnë në treg një numër i madh i armëve dhe i municionit të prodhuar në mënyrë të paligjshme, të cilat armë janë edhe objekt i kontrabandës nga grupet e organizuara kriminale.

Ky Protokoll konsiderohet instrumenti i parë ndërkombëtar dhe më i rëndësishëm detyrues në përmasa globale, qëllimi i të cilit është “[...] të nxisë, të lehtësojë dhe të forcojë bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare, me qëllim parandalimin, luftimin dhe çrrënjosjen e prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit”.⁸²

Shtetet palë në Protokollin e Armëve të Zjarrit marrin përsipër të miratojnë dhe zbatojnë legjislacionin më të fortë të mundshëm në përputhje me sistemin e tyre ligjor kombëtar, për të parandaluar, hetuar dhe ndjekur penalisht veprat që rrjedhin nga prodhimi i paligjshëm dhe trafikimi i armëve të zjarrit. Masat specifike përfshijnë: sekuestrimin, konfiskimin dhe shkatërrimin e armëve të zjarrit të prodhuara ose të trafikuar në mënyrë të paligjshme; mbajtjen e të dhënave për të paktën dhjetë (10 vjet) me qëllim, identifikimin dhe gjurmimin e armëve të zjarrit; lëshimin e licencave për import dhe eksport të armëve të zjarrit dhe autorizimin e kalimit transit përpara transferimit të tyre aktual; dhe shenjat e duhura të armëve të zjarrit që lejojnë identifikimin e prodhuesit të armës së zjarrit, vendin dhe vitin e importit.⁸³

Siç do të shohim në vijim, shtetet palë marrin përsipër të bashkëpunojnë gjerësisht në nivele dypalëshe, rajonale dhe ndërkombëtare për të arritur objektivat e Protokollit të Armëve të Zjarrit, duke përfshirë ofrimin e trajnimit dhe asistencës teknike për palët e tjera. Së fundi, palët marrin përsipër të shkëmbejnë informacione përkatëse specifike për çështje të tilla si prodhuesit e autorizuar, tregtarët, importuesit, eksportuesit dhe transportuesit e armëve të zjarrit, si dhe informacione mbi grupet e organizuara kriminale të njohura se marrin pjesë në prodhimin e paligjshëm dhe trafikimin e artikujve të tillë.⁸⁴

Në nenin 3 të këtij Protokollit është dhënë përkufizimi i termave që ndërlidhen me armët e zjarrit. Kështu, për qëllimet e këtij Protokollit:

- (a) **“Armë zjarri”** do të thotë çdo armë portative me tytë, që realizon, është e projektuar për të realizuar ose mund të konvertohet lehtësisht për të realizuar një qitje të saçmës, plumbit ose predhës me anë të një lënde plasëse, duke përjashtuar armët e zjarrit antike apo riprodhimet e tyre. Armët e zjarrit antike dhe riprodhimet e tyre përkufizohen në përputhje me ligjin e brendshëm. Megjithatë, në asnjë rast, armët e zjarrit antike nuk përfshijnë armë zjarri prodhuara pas vitit 1899;
- (b) **“Prodhim i paligjshëm”** do të thotë prodhimi ose montimi i armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve, ose municionit: (i) Nga pjesët dhe komponentët e trafikuar në

82 Gashi, Rexhep: *Krimi i organizuar*, fq.333.

83 <https://www.unodc.org/unodc/en/firearms-protocol/the-firearms-protocol.html>

84 *Ibid.*

mënyrë të paligjshme; (ii) Pa licencë ose autorizim nga një autoritet kompetent i shtetit palë, ku bëhet prodhimi ose montimi; ose (iii) Pa vendosur shenjat e duhura në armët e zjarrit në momentin e prodhimit, në përputhje me nenin 8 të këtij Protokolli; kurse

- (c) **“Trafik i paligjshëm”** do të thotë importi, eksporti, blerja, shitja, dorëzimi, lëvizja ose transferimi i armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit nga ose përtej territorit të një shteti palë në territorin e një shteti tjetër palë, nëse një nga shtetet në fjalë nuk e autorizon një veprim të tillë, sipas kushteve të këtij Protokolli ose nëse armët e zjarrit nuk janë shënuar në përputhje me nenin 8 të këtij Protokolli. Etiketimi i armëve të zjarrit ka për qëllim identifikimin dhe zbulimin e secilës armë.

Në nenin 4 të këtij Protokolli është parashikuar qëllimi i zbatimit. Kështu, sipas këtij neni, Protokolli duhet të zbatohet për parandalimin e prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit, si dhe për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale të parashikuara në nenin 5 të këtij Protokolli, nëse këto vepra penale janë të natyrës transnacionale dhe përfshijnë një grup të organizuar kriminal. Kurse, në nenin 5 të Protokollit janë parashikuar llojet e veprave penale që duhet të parashihen me legjislacionin e brendshëm të shteteve palë. Sipas këtij neni të Protokollit, çdo shtet palë duhet të adoptojë ligje dhe masa tjera të nevojshme për të parashikuar si vepra penale sjelljet e mëposhtme të kryera me dashje:

- (a) Prodhimi i paligjshëm i armëve të zjarrit, i pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit;
- (b) Trafiku i paligjshëm i armëve të zjarrit, i pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit; dhe
- (c) Falsifikimi, fshirja, zhvendosja ose ndryshimi i paligjshëm i shenjave të armëve të zjarrit, sipas nenit 8 të Protokollit.⁸⁵

Gjithashtu, shtetet palë janë të detyruara të miratojnë edhe masat tjera të nevojshme legjislative për të parashikuar si vepra penale edhe sjelljet që kanë të bëjnë me tentativën dhe bashkëpunimin në kryerjen e veprave penale të lartcekura, pastaj, organizimin, drejtimin, ndihmën, nxitjen (shtytjen), lehtësimin ose këshillimin në kryerjen veprave penale të lartcekura.⁸⁶ Duke u bazuar në nenin 5 të Protokollit, shtetet palë janë të detyruara që në legjislacionet e tyre penale të inkriminojnë veprimet e lartcekura si vepra penale. Përveç këtyre, në nenin 6 të Protokollit, janë paraparë edhe detyrimet e shteteve palë që të miratojnë masa përkatëse ligjore përmes të cilave bëhet i mundur konfiskimi, parandalimi i rënies në duar të personave të paautorizuar, si dhe shkatërrimi i armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit të prodhuar apo trafikuar në mënyrë të paligjshme.

Po ashtu, duhet theksuar se Protokolli përmban edhe dispozita që i referohen parandalimit dhe këto dispozita gjenden në nenet 7-15. Këto dispozita kanë të bëjnë me mbajtjen e evidencës për

⁸⁵ Neni 5, paragrafi 1 i Protokollit.

⁸⁶ Neni 5, paragrafi 2 i Protokollit.

armët e zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit; etiketimin e armëve të zjarrit; çaktivizimin e armëve të zjarrit; licencimin apo autorizimin për eksport dhe import të armëve të zjarrit; shkëmbimin e informacioneve në mes të shteteve; bashkëpunimin, ndihmën teknike, etj. Kështu, në nenin 12 të Protokollit parashihen dispozita që kanë të bëjnë me shkëmbimin e informacioneve ndërmjet shteteve palë lidhur me parandalimin dhe ndjekjen e veprave penale të prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve. Sipas paragrafit 2 të nenit 12 të Protokollit, shtetet palë shkëmbejnë në mes tyre, në përputhje me sistemet e tyre respektive ligjore dhe administrative të brendshme informacione përkatëse për çështje, si në vijim:

- (a) grupet e organizuara kriminale që njihen si pjesëmarrëse ose dyshohen në prodhimin e paligjshëm dhe trafikimin e armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit;
- (b) metodat e fshehjes që përdoren në prodhimin e paligjshëm apo trafikimin e armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit dhe mënyrat e zbulimit të tyre;
- (c) metodat dhe mjetet, pikat e nisjes, përcaktimin dhe rrugët që përdoren zakonisht nga grupet e organizuara kriminale, të përfshira në trafikun e paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit; dhe (d) përvojat legislative, praktikat dhe masat për të parandaluar, luftuar dhe çrrënjësuar prodhimin e paligjshëm dhe trafikimin e armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit. Gjithashtu, në nenin 12 të Protokollit parashihet shkëmbimi i informacioneve shkencore dhe teknologjike, si dhe forma të tjera të bashkëpunimit.

Në këtë Protokoll, gjenden edhe dispozita që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërmjet shteteve palë në nivele dypalëshe, rajonale dhe ndërkombëtare për të parandaluar, luftuar dhe çrrënjësuar prodhimin e paligjshëm dhe trafikimin e armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit. Duhet theksuar se ky bashkëpunim nuk kufizohet vetëm ndërmjet shteteve palë, por ai është më i gjerë dhe përfshin bashkëpunimin e këtyre shteteve palë edhe me organizatat e tjera përkatëse ndërkombëtare në mënyrë që këto shtete palë të marrin ndihmën e nevojshme teknike dhe kualifikuese për të rritur aftësitë e tyre me qëllim të parandalimit, luftimit dhe çrrënjësjes së prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municionit, duke përfshirë edhe asistencë teknike, financiare dhe materiale në këtë fushë.⁸⁷

87 Gashi, Rexhep: *Krimi i organizuar*, fq.336.

4.3 Direktiva (BE) 2021/555 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 24.03.2021, për kontrollin e blerjes dhe posedimit të armëve

Siç është e ditur, vendi ynë më 27.10.2015, në Strasburg e ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit (MSA) me BE-në, mbi bazën e së cilës, përveç tjerash, ka marrë përsipër të përafrojë dhe të harmonizojë legjislacionin e brendshëm me legjislacionin e BE-së. Së këndejmi, bazuar në këtë MSA, është detyrë e vendit tonë të bëjë transpozimin e **“acquis”** të BE-së në sistemin juridik të brendshëm.

Siç është theksuar edhe më parë, në kuadër të BE-së janë miratuar disa akte juridike në fushën e kontrollit të armëve të zjarrit, e që sigurisht se janë të rëndësishme për Kosovën, si shtet i cili aktualisht ka statusin e vendit kandidat potencial për anëtarësim në BE. Për shkak hapësirës, në vijim të këtij punimi do të paraqitet dhe shtjellohet në pika të shkurtra vetëm Direktiva (BE) 2021/555 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 24.03.2021, për kontrollin e blerjes dhe posedimit të armëve.

Direktiva (BE) 2021/555 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 24.03.2021,⁸⁸ për kontrollin e blerjes dhe posedimit të armëve është një akt ligjor i BE-së i cili përcakton standardet minimale në lidhje me blerjen dhe posedimin e armëve të zjarrit, të cilat standarde shtetet anëtare të BE-së duhet t'i inkorporojnë në sistemet e tyre ligjore. Megjithatë, shtetet anëtare të BE-së janë të lira që të miratojnë rregulla edhe më të rrepta, në lidhje me blerjen dhe posedimin e armëve të zjarrit.⁸⁹

Kjo Direktivë⁹⁰ është publikuar më 06.04.2021 dhe ka hyrë në fuqi më 26.04.2021. Sipas kësaj Direktive, **“armë zjarri”** nënkupton çdo armë portative me tytë që realizon, është e projektuar për të realizuar ose mund të konvertohet për të realizuar një qitje të saçmës, plumbit ose predhës, nga veprimi i një lënde shtytëse të djegshme, përveç rasteve kur përjashtohet nga ky përkufizim për një nga arsyet e renditura në pjesën III të aneksit I.⁹¹ Pra, siç shihet, kjo Direktivë ka përvetësuar në përgjithësi përkufizimin e njëjtë të armës së zjarrit që është përcaktuar edhe me Protokollin e Armëve të Zjarrit të KB-së.

Me këtë Direktivë, në masë të madhe janë rregulluar shumë çështje që kanë të bëjnë me blerjen dhe posedimin e armëve të zjarrit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në rregullimin e çështjeve si vijon: shenjat e përhershme dhe të qarta në armët e zjarrit dhe pjesët e

88 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32021L0555>

89 Neni 3 i Direktivës.

90 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32021L0555>

91 Për qëllimet e kësaj shtojce, në përkufizimin e armëve të zjarrit nuk përfshihen: (a) armët që janë projektuar për alarmim, sinjalizim, shpëtim, therje kafshësh ose peshkim me fuzhnjë ose qëllime industriale ose teknike, me kusht që të mund të përdoren vetëm për këto qëllime dhe (b) armët që konsiderohen armë antike.

tyre të prodhuara në BE apo të importuara në BE;⁹² që blerja dhe posedimi i armëve të zjarrit të mund të bëhet vetëm nga ana e personave që posedojnë leje dhe licencë sipas legjislacionit të brendshëm të shteteve;⁹³ që blerja dhe posedimi i armëve të zjarrit t'u lejohet vetëm personave madhorë (mbi 18 vjet), që kanë arsye “të mira” për blerje dhe posedim të armëve të zjarrit dhe që nuk përbëjnë rrezik për veten, për të tjerët apo për rendin publik;⁹⁴ që shtetet anëtare të BE-së duhet të parashohin rregullta të veçanta për të minimizuar rrezikun e qasjes së personave të paautorizuar në armët e zjarrit, pjesët e tyre dhe në municion;⁹⁵ që të sekuestrojnë armët e zjarrit, pjesët e tyre dhe municionin përkatës që mbahet në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore;⁹⁶ mandej, janë rregulluar formalitetet e caktuara për lëvizjen e armëve brenda dhe jashtë BE-së; që shtetet anëtare të intensifikojnë kontrollet e jashtme të kufijve për të parandaluar trafikun ilegal të armëve, etj.

Sipas Shtojcës I të kësaj Direktive, armët e zjarrit klasifikohen në këto kategori:

Kategoria A - që përfshin armët e zjarrit që janë të ndaluara;

Kategoria B - që përfshin armët e zjarrit që i nënshtrohen autorizimit dhe

Kategoria C - që përfshin armët e zjarrit dhe mjetet tjera që i nënshtrohen deklarimit.

92 Neni 4, paragrafi 1 i Direktivës.

93 Neni 5 i Direktivës.

94 Neni 6, paragrafi 1 i Direktivës.

95 Neni 7 i Direktivës.

96 Neni 9, paragrafi 1 i Direktivës.

PJESA E DYTË

Veprat penale të armëve

1. Shqyrtime të përgjithshme

KPK ka të përcaktuar një kapitull të posaçëm të veprave penale të armëve. Kjo për shkak të faktit se armët zakonisht paraqesin mjete të rrezikshme dhe si të tilla nuk mundësohet që qytetarët t'i posedojnë në mënyrë të lirshme. Posedimi i tyre është i kushtëzuar me marrjen e lejeve përkatëse paraprakisht nga organet kompetente. KPK ka përcaktuar format themelore të inkriminimit ligjor, kurse me qëllim të qartësimit se çfarë konsiderohet “armë”, në dispozitën e nenit 113, paragrafi 1, nën-paragrafi 40 të KPK-së janë përkufizuar, përcaktuar dhe kategorizuar armët dhe llojet e tyre. Kurse pjesët përbërëse të veprave penale të armëve janë përcaktuar përmes normave “*blanketë*” të cilat mbështeten në Ligjin për Armë, si dhe në Udhëzimet Administrative të nxjerra nga Ministria e Punëve të Brendshme. Po ashtu, në dispozitat ligjore janë përfshirë disa aspekte të rëndësishme të veprimtarive me armë, duke filluar nga importi, eksporti, mbajtja, përdorimi dhe prodhimi i tyre. Këto inkriminime ligjore janë sistemuar përmes dispozitave përkatëse ligjore.

Si kapitull i rëndësishëm i KPK-së konsiderohet edhe Kapitulli XXIX, në të cilën janë parashikuar veprat penale të armëve. Në këtë Kapitull të KPK-së janë parashikuar gjashtë (6) vepra penale që kanë të bëjnë me armët, dhe atë: *Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse* (neni 364), *Fshirja, heqja apo ndryshimi i kundërligjshëm i shenjave në armë të zjarrit apo në municion* (neni 365), *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* (neni 366), *Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm* (neni 367), *Lejet, pëlqimet dhe licencat e rreme të armëve dhe dhënia e informatave të rreme* (neni 368) dhe *Prodhimi dhe sigurimi i armëve dhe mjeteve për kryerjen e veprave penale* (neni 369).

Karakteristikë themelore të këtyre veprave penale përbën fakti se pjesa dërmuese e këtyre veprave penale kanë të bëjnë me mbajtjen në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve dhe përdorimin e tyre, kurse veprat tjera të përcaktuara në këtë kapitull paraqiten më rrallë në praktikën gjyqësore.

E veçantë e këtyre veprave penale është fakti se ato mund të kryhen edhe nga personat të cilët posedojnë leje për armën, mirëpo nuk u përmbahen lejeve përkatëse të lëshuara apo nuk respektojnë skadimin e lejeve për afatin e përcaktuar.

Veprat penale të këtij Kapitulli janë me karakter “*blanketë*”, ngase për përcaktimin e tipareve të figurës së këtyre veprave penale duhet aplikuar edhe dispozita ligjore të tjera që rregullojnë çështje të caktuara nga fusha e armëve, përkatësisht ligji për armët.

Këto vepra penale bëjnë pjesë në grupin e veprave penale të ashtuquajtura “*delicta communia*”, pasi që kryes i tyre mund të jetë çdo person dhe kryhen vetëm me dashje, kurse mënyra e kryerjes së këtyre veprave penale është se kryhen me veprim.

Duke marrë parasysh faktin se disa nga veprat penale të armëve janë vepra penale të cilat ndërlidhen edhe me mundësi të përfitimit pasuror dhe se armët shpeshherë paraqesin mjete për kryerjen e veprave penale të tjera, te shumica dërmuese e këtyre veprave janë përcaktuar dy dënime: dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim. Te disa vepra penale, dënimet me gjobë dhe me burgim janë paraparë të shqiptohen në formë kumulative, kurse te disa të tjera në formë alternative dhe atë varësisht nga natyra dhe rrezikshmëria e këtyre veprave penale.

Duke marrë parasysh se në këtë kapitull janë paraparë disa vepra penale të llojeve dhe karakteristikave të ndryshme, atëherë edhe përcaktimi i dënimeve është mjaft i ndryshëm, si te dënimet me burgim gjithashtu edhe te dënimet me gjobë. Te dënimet e përcaktuara me gjobë, është karakteristike se te disa vepra penale nuk është përcaktuar as minimumi dhe as maksimumi, kështu që në këto raste aplikohet minimumi dhe maksimumi i përcaktuar ligjor. Kurse, te disa vepra penale është përcaktuar vetëm maksimumi ligjor dhe atë duke filluar nga dymijë e pesëqind (2.500) euro në (dhjetëmijë) 10.000 euro.

Për sa i përket dënimeve me burgim, gjithashtu ka mjaft hapësirë të gjerë mes minimumit dhe maksimumit dhe gjithashtu kryesisht paraqitet në dy forma. Një është ajo ku nuk është përcaktuar fare minimumi ligjor, por vetëm maksimumi i tij. Tjetra është te disa vepra të tjera ku është përcaktuar kufiri mes minimumit dhe maksimumit, një kufi mjaft i lartë e që për dy vepra penale ka margjinë të lartë dënimi duke filluar nga një (1) deri në dhjetë (10) vjet. Duke e analizuar këtë larmi të madhe mes dënimeve të përcaktuara, si për dënimet me gjobë ashtu edhe për ato me burgim, rezulton se ka shumë mundësi që gjykatat të shqiptojnë dënime jo-konsistente, dhe padyshim që si pasojë e kësaj nuk kemi unifikim të politikës ndëshkimore përkritazi me këto vepra penale, andaj për këtë arsye është i domosdoshëm aplikimi i Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore.⁹⁷ Gjithsesi, është e rëndësishme të potencohet fakti se Kodi Penal ka përcaktuar si formë të cilësuar përdorimin e armës apo mbajtjen me vete të saj në hiç më pak se tridhjetë (30) vepra të tjera penale të armëve, që kjo tregon faktin se veprat penale nga ky kapitull duhet konsideruar si vepra penale me rrezikshmëri të lartë.

Për shumicën e këtyre veprave penale është parashikuar shprehimisht edhe konfiskimi i armëve, mjeteve për transportin e armëve, mjeteve për prodhimin e armëve dhe mjeteve të tjera përmes të cilave është kryer vepra penale përkatëse. Në kuadër të këtij Kapitulli gjenden edhe disa dispozita ligjore me karakter shpjegues, pasi që me to shtjellohet domethënia e shprehjeve që janë përdorur në kuadër të elementeve përkatëse të figurës së veprës penale.

97 Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore, Botimi 1, Prishtinë, 2018.

2. Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse (Neni 364, KPK)

2.1 Shqyrtime të përgjithshme

Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse, konsiderohen si veprime të rrezikshme, për faktin se përmes këtyre veprimeve krijohet mundësia reale e kryerjes së veprave penale të tjera, sidomos të vrasjeve të rënda, vrasjeve, grabitjeve, lëndimeve të rënda trupore, etj.

Gjithashtu, duhet theksuar se veprimet e tilla konsiderohen të rrezikshme edhe në rastet kur nuk janë të destinuara për kryerjen e ndonjë vepre penale, sepse ekziston mundësia e shpërthimit të tyre dhe si rrjedhojë edhe e shkaktimit të lëndimeve trupore, humbjes së jetës së njerëzve apo dëmtimeve materiale me përmasa të mëdha, andaj edhe këto janë arsye e inkriminimit të veprimeve të tilla.

Te kjo vepër penale janë përcaktuar dënimet me gjobë dhe me burgim, pra në mënyrë kumulative dhe kjo për faktin se veprat penale të përcaktuara në këtë nen kanë mundësinë e sjelljes së përfitimeve materiale për autorët e veprave penale.

Teksti ligjor:**NENI 364****Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse**

- (1) Kushdo që në kundërshtim të ligjit të zbatueshëm në lidhje me armët apo materiet plasëse, importon, eksporton, blen, furnizon, transporton, prodhon, këmben, ndërmjetëson ose shet armë apo materie plasëse, dënohet me gjobë deri në shtatë mijepesëqind (7.500) Euro dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë, më shumë se katër (4) materie plasëse apo më shumë se katër qind (400) fishekë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
- (3) Për qëllime të këtij neni, shprehja “prodhim” i armëve përfshin shndërrimin apo modifikimin e ndonjë sendi në armë ose të një arme në një lloj tjetër të armës, apo deaktivizimin ose riaktivizimin e ndonjë arme.
- (4) Armët, mjetet për transportimin e armëve dhe mjetet për prodhimin e armëve konfiskohen.

Paragrafi 1

Me paragrafin 1 të nenit 364 të KPK-së, është paraparë forma themelore e kësaj vepre penale, kurse veprimet kryesë të kësaj forme të veprës penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe përbëhen nga: importimi, eksportimi, blerja, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e armëve apo materieve plasëse.

Për të ekzistuar kjo formë e veprës penale duhet që veprimet kryesë të ndërmerren në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse, ndërsa për këtë formë të veprës penale është parashikuar dënim me gjobë deri në shtatë mijepesëqind (7.500) euro dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Sipas kësaj dispozite ligjore, veprimet kryesë të kësaj forme të veprës penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe përbëhen nga : importimi, eksportimi, blerja, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e armëve apo materieve plasëse. Duhet theksuar fakti se veprimi i kryerjes është përcaktuar në mënyrë alternative, megjithëse për të gjitha format e saj nuk janë dhënë përkufizime, përveç prodhimit që është përkufizuar

me dispozitën e paragrafit 3 të këtij neni. Kurse shprehjet e tjera të përdorura janë paraqitur në Ligjin për Armë, ku janë dhënë përkufizimet si në vijim:

Import - aplikimi i formaliteteve të hyrjes mbi mallra duke përfshirë procedurat e politikës komerciale dhe në raste përkatëse detyrimet e importit në përputhje me rregullat doganore.

Eksport - aplikimi i formaliteteve të daljes mbi mallra duke përfshirë procedurat e politikës komerciale dhe në raste përkatëse detyrimet e eksportit në përputhje me rregullat doganore.

Furnizimi nënkupton veprimet e ndryshme me anë të të cilave sigurohen armët apo mjetet plasëse.

Transportimi nënkupton veprimet e atilla me anë të të cilave armët ose materiet plasëse barten nga një vend në një vend tjetër.

Prodhimi përfshin shndërrimin apo modifikimin e ndonjë sendi në armë ose të një arme në një lloj tjetër të armës, apo deaktivizimin ose riaktivizimin e ndonjë arme.⁹⁸

Këmbimi nënkupton veprime të atilla me anë të të cilave ndërrohen apo këmbehen armët apo materiet plasëse me ndonjë send tjetër me vlerë që mund të jetë sasi e arit, automobil apo edhe materie të ndaluara siç mund të jenë lëndët e ndryshme narkotike.

Ndërmjetësimi - aktiviteti i personave juridikë të licencuar që sigurojnë shërbime gjatë negociimit apo aranzhimeve të transaksioneve për blerje, shitje apo furnizim të armëve, pjesëve të armëve dhe municionit, nga shteti i tretë në një shtet tjetër të tretë apo shitja dhe blerja e armëve, pjesëve të armëve dhe municionit, që janë të vendosura në shtetet e treta për transferim të tyre në një shtet tjetër të tretë.

Shitja nënkupton veprime të atilla me anë të të cilave ndërrohet arma me para.

Objekti i kësaj vepre penale janë **armët** dhe **materiet plasëse**. Bazuar në nenin 113, paragrafi 40 të KPK-së, **“armë”** konsiderohet çdo send ose vegël e punuar me qëllim që nën presionin e gazrave, të cilat lirohen gjatë djegies së materieve shpërthyes, elektrike, gazrave nën presion ose energjisë tjetër potenciale, hedh predha në formë të një plumbi të vetëm, grumbulli prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose përbërësish të tjerë, që krijohet dhe përdoret për të shkaktuar lëndime trupore ose dëm fizik, qoftë edhe psikologjik, si dhe secili send tjetër, qëllimi kryesor i të cilit është kryerja e sulmit fizik ndaj integritetit fizik të njerëzve ose ndaj pasurisë. Armë po ashtu përfshin municionin, pjesët dhe përbërësit e armëve, si dhe armët nukleare, biologjike dhe kimike.

98 Neni 364, paragrafi 3, KPK.

Kurse, në nenin 2, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7. të Ligjit për Armë,⁹⁹ është parashikuar se **“armë”** konsiderohet secili mjet ose vegël e punuar me qëllim që nën presionin e gazrave të cilat shkaktohen gjatë djegies së materialeve shpërthyesë, elektricitetit, gazrave nën presion ose energjisë tjetër potenciale, të hedhë predha, grumbullit prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose përbërësish të tjerë, që është e përcaktuar ose është përdorur për të shkakuar dëm trupor, dëm fizik, dëm psikologjik dhe po ashtu çdo mjet tjetër qëllimi i të cilit është të bëjë sulm fizik ndaj integritetit fizik të njerëzve ose pronës.

Sipas nenit 2, paragrafi 1.41. të Ligjit për Armë, fishekët, diabolat dhe predhat e tjera së bashku me fitilat dhe mbushësit e tyre konsiderohen municion. Kurse, sipas kësaj dispozite ligjore, **“fisheku”** përkufizohet si njësi e municionit për armën e zjarrit e cila paraqet kombinimin e ndezësit, mbushësit gëzhhojës dhe predhës në një njësi të vetme, kurse fisheku me saçme është njësi e municionit për armë të zjarrit e cila paraqet kombinimin e saçmave (pjesë e vogël sferike), ndezësit, mbushësit dhe të gëzhhojës në një njësi të vetme.

Kjo vepër penale është përcaktuar me normë **“blanketë”**, meqë për të ekzistuar kjo formë e veprës penale duhet që veprimet kryese të ndërmerren në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse, që do të thotë se edhe kjo vepër penale është me karakter **“blanketë”**. Në këtë mënyrë, nëse veprimet e lartcekura ndërmerren në bazë të ligjit dhe nga personat e autorizuar, atëherë të njëjtat nuk konsiderohen vepër penale.

Për formën themelore të kësaj vepre penale është parashikuar dënim me gjobë deri në shtatë mijepesëqind (7.500) euro dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Kjo vepër penale në të gjitha format e saj mund të kryhet vetëm me dashje, kurse kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person. Kurse ana subjektive e kësaj vepre penale kryhet kur personi ndërmerr veprime për të cilat nuk ka qenë i autorizuar.

Paragrafi 2

Forma e kualifikuar e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë, më shumë se katër (4) materie plasëse apo më shumë se katërqind (400) fishekë, dhe për të cilën është parashikuar dënim me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet. Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, rezulton se një (1) armë apo një (1) materie plasëse është e barasvlershme me njëqind (100) fishekë, në kuptim të kualifikimit juridik të kësaj vepre penale.

Në këtë paragraf janë paraqitur shprehimisht minimumi i sasisë së armëve, materieve plasëse dhe fishekëve për t’u konsideruar sasi e madhe dhe kjo padyshim se heq dilemat përkritazi me sasinë e armëve. Për më tepër, derisa shumica e shteteve të rajonit nuk e kanë

⁹⁹ Ligji nr.05/L-022 për Armët, datë 23.07.2015.

bërë këtë përkufizim të sasisë së armëve përmes legjislacionit të tyre dhe kjo është bërë përmes vendimeve të gjykatave më të larta, ndërsa çështja e sasisë së madhe përbën çështje të fakteve (*“quaestio facti”*), pra vlerësohet rast pas rasti. Mirëpo, kjo shpeshherë shkakton një problematikë të praktikës gjyqësore përkitazi me sasinë e armëve, për faktin se në një rast sasia prej 660 armëve është konsideruar si sasi e madhe, kurse në rastin tjetër sasia prej 75 revoleve gjithashtu është konsideruar sasi e madhe, gjë që paraqet jo-konsistencë të vendimeve gjyqësore. Kurse, legjislacioni ynë përmes përcaktimit të shprehur të sasisë së armëve, konsiderojmë se është mjaft i avancuar duke përcaktuar përmes bazës ligjore sasinë e madhe dhe duke hequr dilemat eventuale dhe njëkohësisht duke harmonizuar praktikën gjyqësore e cila njëkohësisht ndikon drejtpërdrejt edhe në harmonizimin e politikës ndëshkimore për kryesit e këtyre veprave penale.

Paragrafi 3

Përmbajtja e këtij paragrafi është dispozitë ligjore me karakter shpjegues, pasi në të është shtjelluar se për qëllime të këtij neni, shprehja “prodhim” i armëve përfshin shndërrimin apo modifikimin e ndonjë sendi në armë ose të një arme në një lloj tjetër të armës, apo deaktivizimin ose riaktivizimin e ndonjë arme.

Paragrafi 4

Kurse, në paragrafin 4 të nenit të lartcekur është parashikuar konfiskimi i detyrueshëm i armëve, mjeteve për transportimin e armëve dhe mjeteve për prodhimin e armëve. Me këtë paragraf shprehimisht është përcaktuar konfiskimi i detyrueshëm i armëve, mjeteve për transportin e armëve dhe mjeteve për prodhimin e tyre që paraqet një aspekt të rëndësishëm në drejtim të parandalimit të këtyre veprave penale dhe se pos dënimit është përcaktuar edhe konfiskimi i detyrueshëm. Në praktikën gjyqësore nuk është kontestues konfiskimi i armëve dhe mjeteve për prodhimin e tyre, mirëpo problematika është paraqitur te mjetet e transportit e kjo veçanërisht në rastet kur automjetet nuk kanë pasur vend të posaçëm për transportin e armëve, por armët janë bartur me automjete të pamodifikuara për transportin e armëve.

Analizë e lëndëve nga praktika gjyqësore:

I Në çështjen penale sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjiilan PKR. nr.133/2022, datë 12.07.2023, për shkak të veprës penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”, nga neni 364, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, i cili aktgjykim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.667/2023, datë 25.01.2024.

Në këtë çështje penale i pandehuri S.M., është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjiilan, për shkak të veprës penale *“Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi,*

ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”, nga neni 364, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, pasi më 10.07.2022, rreth orës 20:00, në pikën kufitare “Dheu i Bardhë”, Komuna e Kamenicës, i pandehuri në kundërshtim me Ligjin për Armë, ka importuar në mënyrë të paautorizuar municion-diabollë, edhe atë, derisa Policia kanë qenë në zbatim të Planit Operativ “Ngritja e Vigjilencës dhe Masave të Sigurisë” në hyrje të Kosovës, në pikën kufitare të lartpërmendur, ndaluan autobusin e Kompanisë Turistike “TTT” me tabela 05-000-AA, dhe gjatë kontrollit të valixheve të të pandehurit, gjejnë dhe sekuestrojnë një sasi municioni 10 (dhjetë) pako x 250 copë, për pushkë ajrore, e të cilat i njëjti nuk i kishte deklaruar dhe nuk kishte dokumente për blerjen e tyre.

Gjykata Themelore në Gjilan, të pandehurin S.M., e ka shpallur fajtor për shkak të kësaj vepre penale dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej pesëqindpesëdhjetë (550) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje njëqindetëdhjetë (180) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit prej 1 (një) viti, si dhe ka urdhëruar konfiskimin e municionit të lartcekur.

Me këtë rast si çështje ligjore është ngritur nëse të ashtuquajturat “diabolla” konsiderohen armë të zjarrit, në kuptim të dispozitave ligjore të aplikueshme. Në lidhje me çështjen e ngritur, gjykatat kompetente si më sipër kanë arsyetuar, se veprimet e të pandehurit S.M., i përbëjnë të gjitha elementet e figurës së veprës penale për të cilën ishte akuzuar, pasi që “diabollat” konsiderohen armë në kuptim të dispozitave ligjore të aplikueshme. Kjo për faktin se me dispozitën e nenit 2, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.41. të Ligjit nr. 05/L-022 për Armë, përcaktohet qartazi se “Municion [përfshin]- fishekët, **diabollat** dhe predhat e tjera së bashku me fitilat dhe mbushësit e tyre”. Ndërsa në pikën 1.41.3. është parashikuar se “**diabolla** është predhë jo sferike e paraparë për qitje nga armë pneumatike”. Andaj, pretendimi ankimor se është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit, duke konsideruar, sipas mbrojtjes, se diabollat nuk bien në domenin e veprës penale, për arsye se të njëjtat nuk janë lëndë plasëse, por hyjnë në grupin për rekreacion apo armë ajrore u vlerësua i pabazuar dhe në këtë drejtim edhe kolegji penal i Gjykatës së Apelit u pajtua me konstatimin e gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari me veprimet e veta ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor dhe dënuar si në dispozitiv të aktgjyqimit të ankimuar.

Konsiderojmë se përmes këtij vendimi gjyqësor është qartësuar fakti se edhe diabollat bëjnë pjesë në grupin e armëve sipas dispozitave të sipërcituara të Ligjit për Armë dhe kjo duhet të shërbejë për unifikimin e praktikës gjyqësore.

II Në çështjen penale sipas aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan PKR. nr.71/2021, datë 15.09.2021, për shkak të veprës penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”, nga neni 364, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, i cili aktgjykim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.437/2021, datë 30.11.2021, si dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin Pml. 39/2022, datë 14.02.2022.

I pandehuri R.D., shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjiilan, për shkak të veprës penale “*Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo mjeteve plasëse*”, të parashikuar me nenin 364 paragrafi 1 të KPK-së, pasi në fund të qershorit të vitit 2019, pa autorizim ka shitur armën e zjarrit – pushkën e gjuetisë të markës “*Canne Cromate*”, prodhim italian, e kalibrit 12 Ga, me 62 fishekë.

Gjykata Themelore në Gjiilan, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin R.D., e ka shpallur fajtor për shkak të kësaj vepre penale dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e dy (2) muaj dhe dënim me gjobë në lartësi prej dyqind (200) euro. Kurse, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin e lartcekur, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë çështje penale është ngritur si çështje e natyrës ligjore se, a konsiderohet që është kryer kjo vepër penale në rastet kur bëhet fjalë vetëm për një armë, meqë kjo vepër penale do të konsiderohej e kryer kur kemi të bëjmë me sasi më të madhe të armëve, përkatësisht më shumë se një armë, dhe kryhet si veprimtari e përsëritur tregtare apo në formë të biznesit.

Mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi në fjalë nuk ishte i bazuar, meqë, neni 364 i KPK-së është i përbërë nga katër paragrafë, ku në paragrafin e parë është përcaktuar forma themelore e kësaj vepre penale, me ç’rast inkriminon ndër të tjera edhe veprimin e shitjes së armëve, kurse me paragrafin e dytë është paraparë forma e kualifikuar e saj në të cilën inkriminohen veprimet ku përfshihet sasi më e madhe e armëve. Nga kjo rrjedh se gjykata e shkallës së dytë me të drejtë ka konstatuar se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar elementet e veprës penale “*Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo mjeteve plasëse*” nga neni 364, paragrafi 1 i KPK-së. Ndonëse dispozita ligjore përfshin disa mënyra të veprimit për t’u konsumuar vepra penale, megjithatë veprimet e të dënuarit janë përshkruar dhe konkretizuar në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ku është theksuar fakti se i njëjti kishte bërë shitjen e armës së gjuetisë dhe për të cilin veprim ishte shpallur fajtor dhe i ishte shqiptuar dënimi përkatës, ashtu që nga kjo rrjedh se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal. Pra, kjo vepër penale mund të kryhet edhe nëse realizohen elementet e kësaj vepre penale edhe me një armë të vetme, mirëpo qëllimi i të akuzuarit duhet të jetë në realizimin e elementeve objektive dhe subjektive të kësaj vepre penale.

3. Fshirja, heqja apo ndryshimi i kundërligjshëm i shenjave në armë të zjarrit apo në municion (Neni 365, KPK)

3.1 Shqyrtime të përgjithshme

Sipas përcaktimit të kësaj vepre penale: fshirja, heqja apo ndryshimi i kundërligjshëm i shenjave në armë të zjarrit apo në municion, konsiderohen veprime të cilat kanë për qëllim primar ndryshimin e shenjave të armëve apo municionit në mënyrë kundërligjshme dhe i cili veprim mund të bëhet për arsye të ndryshme.

Duhet theksuar se kjo vepër penale është inkriminuar në legjislacionin tonë penal më vonë dhe sanksionon veprimet që kanë të bëjnë me abuzimin e shenjave të cilat i ka vënë prodhuesi apo organi shtetëror me qëllim të identifikimit të armëve, kjo për qëllim të zbulimit më të lehtë të llojeve të armëve të cilat janë përdorur me rastin e kryerjes së veprave penale, e me këtë edhe të autorëve të këtyre veprave penale.

Përmes kësaj vepre penale mbrohet vërtetësia e llojit të armës dhe municionit.

Me kryerjen e kësaj vepre penale bëhet abuzimi me shenjat e prodhuesit apo organit shtetëror, shenja këto me të cilat përcaktohet dhe identifikohet lloji dhe modeli i armës, si dhe lloji dhe kalibri dhe vetitë e tjera të municionit.

Teksti ligjor:**NENI 365****Fshirja, heqja apo ndryshimi i kundërligjshëm i shenjave në armë të zjarrit apo në municion**

- (1) Kushdo që fshin, heq apo ndryshon shenjat në armë të zjarrit apo municion ose kushdo që e shënjon një armë të zjarrit apo municion me shenja të rrejshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
- (2) Kushdo që prodhon armën e zjarrit apo municionin dhe nuk e shënjon armën e zjarrit apo municionin në kohën e prodhimit sipas ligjit të zbatueshëm lidhur me shënjimin e armëve, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë ose më shumë se katërqind (400) fishekë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.
- (4) Për qëllime të këtij neni, shprehja “shenjë” do të thotë një shenjë identifikuese e cila vendoset në armën e zjarrit apo në municion nga prodhuesi ose nga organi kompetent shtetëror.
- (5) Arma e zjarrit apo municioni konfiskohen. Mjeti i cili përdoret për fshirjen, heqjen apo ndryshimin e shenjës apo për shënjimin e rrejshëm konfiskohet.

Paragrafi 1

Sipas paragrafit 1 të nenit 365 të KPK-së, veprimet kryese të kësaj forme të veprës penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe përbëhen nga: fshirja, heqja apo ndryshimi i shenjave në armë të zjarrit apo municion ose vendosja e shenjave të rreme në armë zjarrit apo municion. Për këtë formë të veprës penale është parashikuar dënim me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Bazuar në faktin se armët duhet të përmbajnë shënime të sakta lidhur me vendosjen e shenjës unike duke përfshirë emrin e prodhuesit, vendin e prodhimit, numrin e serisë, vitin e prodhimit, si dhe shenja tjera të cilat mundësojnë identifikimin e armës nga shtetet e treta, e që përmes këtyre shenjave arma përkatësisht municioni merr një shenjë identifikuese përmes së cilës bëhet identifikimi i saj dhe përmes kësaj arrihet të vendoset kontrolli dhe lokacioni i armës apo municionit në shtetin ku prodhohet arma, por edhe në shtetin i cili e importon atë. Gjithsesi, kjo vepër penale mund të kryhet duke bërë fshirjen e veçorive identifikuese të armëve apo municionit, heqjen në tërësi të këtyre shenjave, e po ashtu edhe me ndryshimin

e tyre. Kjo mund të kryhet edhe nga personat që posedojnë leje për këto armë sikurse edhe personat që nuk posedojnë leje të armëve. E rëndësishme është të theksohet fakti se autori i kësaj vepre penale i cili nuk posedon leje për armë është përgjegjës për të dy veprat penale, pra edhe për këtë vepër penale, edhe për veprën penale mbajtje e paautorizuar e armës.

Paragrafi 2

Formë e kualifikuar e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur prodhuesi i armës së zjarrit apo municionit nuk e vendos shenjën e duhur në armën e zjarrit apo municionin në kohën e prodhimit sipas ligjit të zbatueshëm lidhur me shenjat në armë, për të cilën është parashikuar dënim me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Duhet pasur parasysh se kjo vepër penale kryhet vetëm nga prodhuesi i armës apo municionit, kjo nënkupton se përgjegjës mund të jetë personi përgjegjës i personit juridik. Meqenëse është përdorur shprehja kushdo, kjo padyshim se nënkupton çdo prodhues të armëve.

Paragrafi 3

Ndërsa, formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur veprat penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë ose më shumë se katërqind (400) fishekë, për të cilën është parashikuar dënim me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet. Pra, përmes kësaj dispozite është përcaktuar sasia e madhe e armëve e në mënyrë të ngjashme është përcaktuar edhe sasia e armëve dhe e municionit.

Paragrafi 4

Ky paragraf është dispozitë ligjore me karakter shpjegues, pasi në të është dhënë shpjegimi se për qëllime të këtij neni, shprehja **“shenjë”** do të thotë një shenjë identifikuese e cila vendoset në armën e zjarrit apo në municion nga prodhuesi ose nga organi kompetent shtetëror.

Kjo vepër penale në të gjitha format e saj mund të kryhet vetëm me dashje, kurse kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, pra edhe personat fizikë e po ashtu edhe personat juridikë, por e rëndësishme është të theksohet se duhet të abuzohet me shenjat e armëve qoftë të prodhuesit apo edhe shenjën që e vendosin shtetet të cilat importojnë armën apo municionin.

Paragrafi 5

Kurse, në paragrafin 5 të nenit të lartcekur është parashikuar konfiskimi i detyrueshëm i armës së zjarrit, municionit, si dhe mjetit me të cilën është kryer vepra penale, përkatësisht mjetit që është përdorur për fshirjen, heqjen apo ndryshimin e shenjës.

4. Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve (Neni 366, KPK)

4.1 Shqyrtime të përgjithshme

Vepra penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve është ndër faktorët që rrezikon sigurinë e qytetarëve dhe sigurinë e vendit. Armët të cilat mbahen nga ana e qytetarëve janë ndër faktorët që kontribuojnë në kryerjen e veprave penale e posaçërisht të veprave penale kundër jetës dhe trupit, por edhe të veprave penale të cilat cenojnë edhe sigurinë e vendit. Padyshim se për vendin tonë, si vend i dalë nga një konflikt me përmasa të gjera, por edhe për rajonin, mundësia e sigurimit ilegal të armëve është më e shprehur për shkak të konflikteve paraprake, andaj kjo ka determinuar që kjo vepër të inkriminohet si vepër penale.

Teksti ligjor:

NENI 366

Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve

- (1) Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijëpesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë ose më shumë se katërqind (400) fishekë, kryesi dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.
- (3) Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet.

Paragrafi 1

Veprimet kryese të formës themelore të kësaj vepre penale përbëhen nga mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të armëve në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla, për të cilat është parashikuar dënim me gjobë deri në shtatë mijesëqind (7.500) euro ose dënim me burgim deri në pesë (5) vjet.

Veprimet kryese të kësaj forme të veprës penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe përbëhen nga mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të armës në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla.

Meqenëse vepra penale kryhet në mënyrë alternative, atëherë është i nevojshëm përkufizimi i këtyre nocioneve dhe atë së pari, mbajtja në pronësi e armëve kryhet në rastet kur autori është pronar i armës të cilën e mban, kurse **kontrolli** nënkupton rastet kur arma është nën kontrollin e personit që nuk është pronar i armës. Kurse, **posedimi** nënkupton rastet kur personi ka pushtetin faktik mbi armën.

Objekt mbrojtës i kësaj vepre penale është mbrojtja nga cenimi, çrregullimi apo rrezikimi në çfarëdo mënyre i rendit dhe qetësisë publike, përkatësisht paqes së qytetarëve përmes përdorimit të armëve, ndërsa në mënyrë të tërthortë rrezikohet edhe jeta dhe integriteti trupor, përkatësisht siguria e përgjithshme e njerëzve dhe e pasurisë së tyre. Përndryshe objekt i kryerjes së kësaj vepre penale janë armët, përkufizimi i së cilave është përcaktuar më lart, përkatësisht me dispozitën e nenit 113 paragrafi 40 i KPK-së dhe nenin 2, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7 i Ligjit për Armë.

Kjo vepër penale është e karakterit “*blanketë*” dhe për të ekzistuar kjo formë e veprës penale duhet që veprimet kryese të ndërmerren në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët.

Në këtë mënyrë, nëse veprimet e lartcekura ndërmerren në bazë të ligjit dhe nga personat e autorizuar, atëherë të njëjtat nuk konsiderohen vepër penale.

Përndryshe kjo vepër penale për nga mënyra kryhet vetëm me dashje, kurse ana subjektive e saj manifestohet përmes mbajtjes në pronësi, posedim apo kontroll të armës në kundërshtim me ligjin për armët. Pra, dispozitat përkatëse të Ligjit për Armë kanë përcaktuar shprehimisht mënyrën e blerjes dhe posedimit të armëve, si dhe mënyrën e pajisjes me leje përkatëse për armët e që mosrespektimi i këtyre rregullave është përcaktuar si veprim inkriminues.

Paragrafi 2

Forma e kualifikuar e kësaj vepre penale e parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni konsiderohet se është kryer në rastet kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë ose më shumë se katërqind (400) fishekë, ndërsa për këtë formë të

kësaj vepre penale është parashikuar dënim me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet. Pra, përmes dispozitës së lartcekur është përkufizuar si formë e kualifikuar kur bëhet fjalë për sasi e cila është e përcaktuar.

Kjo vepër penale në të gjitha format e saj mund të kryhet vetëm me dashje, kurse kryes i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Paragrafi 3

Në këtë paragraf është parashikuar konfiskimi i detyrueshëm i armës e që kjo gjithsesi paraqet normë detyruese që të bëhet konfiskimi i armës.

Analizë e lëndëve nga praktika gjyqësore:

I Në çështjen penale sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjiilan PKR. nr.206/2021, datë 25.05.2023, për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, të parashikuar me nenin 366, paragrafi 1 të KPK-së, i cili aktgjykim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.483/2023, datë 21.09.2023.

Në këtë rast i pandehuri R.M., shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjiilan për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, të parashikuar me nenin 366, paragrafi 1 të KPK-së, pasi më 21.09.2021, rreth orës 11:30, në rrugën “Adem Jashari”, në Gjiilan, i akuzuari në kundërshtim me ligjin për armët, ka mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar armën e vet, pistoletë e prodhimit “Tisas”, modeli “Zigana Sport”, kalibër 9 mm, dhe një karikator me pesë (5) fishekë, në atë mënyrë që pasi e ndalon dhe e parkon automjetin e vet në trotuar dhe nga bagazhi i automjetit merr çantën e krahut në të cilën kishte pistoletën, të njëjtën e vendos në krah dhe shkon përballë kafeterisë “AAA” dhe pas fjalosjes me të dëmtuarin R.B., dhe shokun e tij - I.M., i akuzuari e fut dorën në çantë për të nxjerrë pistoletën dhe në këtë moment i dëmtuari së bashku me I., reagojnë shpejt dhe me forcë ia marrin çantën me pistoletë dhe të njëjtën e dorëzojnë në polici, ku pistoletë dhe fishekët sekuestrohen nga policia.

Gjykata Themelore në Gjiilan, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin R.M., e ka shpallur fajtor për shkak të kësaj vepre penale dhe i ka shqiptuar me dënim me gjobë në shumë prej katërqind (400) euro, si dhe i ka konfiskuar pistoletën dhe pesë (5) fishekët. Kurse, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin e lartcekur, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjiilan dhe ankesën e mbrojtësit të të pandehurit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë rast është ngritur çështja ligjore se, a konsiderohet vepër penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, e parashikuar me nenin 366, paragrafi 1 të

KPK-së, rasti kur personi posedon leje për armë dhe me këtë armë lëviz në vende të ndryshme, mirëpo nuk siguron leje të veçantë për bartjen e armës apo për lëvizjen me armë?

Në lidhje me çështjen e lartcekur, gjykatat kompetente kanë arsyetuar, se veprimet e tilla konsiderohen vepër penale, andaj edhe pretendimet e mbrojtjes janë refuzuar si të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, ka paraqitur arsytet për të gjitha faktet vendimtare që kanë të bëjnë me veprën penale nga neni 366, paragrafi 1 të KPK-së dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarit sa i përket kësaj vepre penale. Provat në këtë çështje penale janë vlerësuar në mënyrën e duhur, ashtu siç parashihet me nenin 360, paragrafi 1 të KPP-së, kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale, dhe po ashtu, edhe për mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e kësaj vepre penale, për më tepër, edhe vet i akuzuari ka pranuar se armën në posedim e ka pasur me leje, mirëpo nuk ka pasur leje të veçantë për bartjen e armës, e që në fakt sipas ligjit për armët, përveç sigurimit të lejes për poligon, i njëjti është dashur të marrë edhe leje të veçantë për lëvizje me armë, prandaj edhe për këtë vepër penale, gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkluzionet e veta, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

II Në çështjen penale sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjiilan PKR. nr.11/2023, datë 03.04.2023, për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, të parashikuar me nenin 366, paragrafi 1 të KPK-së, i cili aktgjykim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.312/2023, datë 18.10.2023, si dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin Pml.nr.607/2023, datë 30.11.2023.

I pandehuri G.D., shtetas i Kosovës, ishte akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjiilan, përveç veprave të tjera penale, edhe për shkak të veprës penale: “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366, paragrafi 1 i KPK-së, pasi më 10.12.2022, gjatë intervalit kohor 20:15-21:00, në Gjiilan, në banesën e tij, pa autorizim dhe pa leje të vlefshme, e në kundërshtim të ligjit të zbatueshëm për armët, ka mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim: gjashtë (6) fishekë 9 mm; dy (2) fishekë 7.65 mm dhe një (1) gëzhhojë 7.65 mm, në atë mënyrë që pas kontrollit, këto i gjenden dhe i sekuestrohen nga ana e Policisë së Kosovës.

Gjykata Themelore në Gjiilan, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin G.D., e ka shpallur fajtor për kryerjen e kësaj vepre penale dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej katërqind (400) euro, si dhe i ka konfiskuar fishekët dhe gëzhhojën. Kurse, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin e lartcekur, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit G.D., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, kurse aktgjykimet e gjykatave kompetente të instancave më të ulëta janë vërtetuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin Pml.nr.607/2023, datë 30.11.2023.

Çështja ligjore që është ngritur nga mbrojtja në disa raste nga praktika jonë gjyqësore ka të bëjë me faktin “nëse vetëm posedimi i paautorizuar dhe në kundërshtim me ligjin vetëm i fishekëve pa armë” përbën veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 i KPK-së, apo duhet patjetër të ekzistojë edhe një armë, në kuptimin e armës së zjarrit, në rastin konkret, pistoletë?

Në lidhje me çështjen e lartcekur, duke u bazuar në nenin 113, paragrafi 40 të KPK-së lidhur me nenin 2, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.41 të Ligjit nr. 05/L-022, datë 23.07.2015, në praktikën tonë gjyqësore është përqafuar qëndrimi juridik se veprë penale e përcaktuar si “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 i KPK-së, konsiderohet edhe “posedimi i paautorizuar dhe në kundërshtim me ligjin i fishekëve”, pasi edhe fishekët konsiderohen armë, në kuptimin juridiko-penal.

Gjykata pasi analizoi të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha një nga një, si dhe ndërlidhur me njëra-tjetrën, duke u bazuar në nenet 8 dhe 360 të KPP-së, konstatoi këtë gjendje faktike: Se ditën kritike ... policia kanë shkuar në vend të ngjarjes, kanë bërë fotografimin e vendit të ngjarjes, me ç'rast edhe kanë sekuestruar gjashtë (6) copë fishekë 9 mm, dy (2) copë fishekë 7.65 mm dhe një (1) gëzhjojë 7.65 mm ... dhe në këtë mënyrë ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366, paragrafi 1 i KPK-së.

III Në çështjen penale sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.111/2022, datë 12.10.2022, për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, të parashikuar me nenin 366, paragrafi 1 të KPK-së, i cili aktgjykim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.601/2022, datë 06.12.2022, si dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin Pml.nr.28/2022, datë 06.02.2022.

I pandehuri P.B., shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, të parashikuar me nenin 366, paragrafi 1 të KPK-së, pasi nga 31.07.2018 gjer më 22.12.2020, rreth orës 15:00, në Gjakovë në Rr. “UÇK”, pa autorizim ka mbajtur në pronësi dhe posedim armë dhe municion, në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 të Ligjit për Armë të Kosovës, të cilat me ligj kategorizohen si armë zjarri të ndaluara dhe atë 1 (një) armë të markës “Sig Sauer P22 elite”, në atë mënyrë që i pandehuri në datën e lartcekur është paraqitur në Stacionin Policor në Gjakovë dhe i kishte njoftuar se për armen e lartcekur i kishte skaduar leja më 30.07.2018, pra rreth 2 (dy) vjet e gjysmë më parë, dhe se nuk ka bërë kërkesë për vazhdimin e lejes, andaj në mungesë të lejes së vlefshme arma dhe karikatori u sekuestruan nga zyrtarët policorë.

Gjykata Themelore në Gjakovë, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin R.M., e ka shpallur fajtor për shkak të kësaj veprë penale dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej gjashtëqind (600) euro, si dhe ka urdhëruara konfiskimin e përhershëm të revoles së tipit “SIG-Sauer P-22 Elite”.

Kurse, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin e lartcekur, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Në këtë rast është ngritur çështja se, a konsiderohet vepër penale *“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”*, e parashikuar me nenin 366, paragrafi 1 të KPK-së, në rastet kur personi ka poseduar leje për armë, mirëpo ajo leje ka skaduar dhe poseduesi i saj nuk ka aplikuar për vazhdimin e lejes për armën e tij?

Në lidhje me çështjen e lartcekur, gjykatat kompetente kanë arsyetuar, se veprimet e tilla konsiderohen vepër penale dhe se fakti që i pandehuri nuk ka bërë kërkesë për vazhdimin e vlefshmërisë së lejes për armën e tij do të thotë se nuk ka poseduar leje fare, andaj edhe pretendimet e mbrojtjes janë refuzuar si të pabazuara.

Duke shqyrtuar pretendimet konkrete të paraqitura në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit, është vërtetuar fakti se i dënuari ka pasur leje të vlefshme për armë të shenjëtarie për armën e markës *“SIG Sauer”*, modeli *“P220 Elite”*, nga 31.07.2013 deri më 30.07.2018. Mirëpo, nga dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe shkresat e lëndës del se nga 31.07.2018 deri më 22.12.2020 ka mbajtur armën pa autorizim, meqë kishte skaduar vlefshmëria e saj, dhe atë në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të Ligjit nr. 05/L-022 për Armë, përkatësisht se nga skadimi i lejes së armës bazuar në numrin e kartelës, del se nuk ka pasur leje të vlefshme për armë.

Duke vlerësuar pretendimet përkitazi me shkeljen e ligjit penal, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoi se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore me të drejtë kanë konstatuar se në veprimet e të akuzuarit janë formësuar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale *“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”*, nga neni 366, paragrafi 1 i KPK-së. Dispozita e lartcekur e KPK-së është normë *“blanketë”* dhe i referohet Ligjit nr. 05/L-022 për Armë, konkretisht dispozitës së nenit 37, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., duke përcaktuar se: *“...leja e lëshuar revokohet në rast të skadimit të lejes kur e njëjta nuk është vazhduar...”*. Kështu që duke marrë parasysh dispozitën në fjalë del se i akuzuari që nga 30.07.2018, gjegjësisht data e skadimit të lejes, nuk ka poseduar leje të vlefshme për mbajtjen e armës, meqë vetë poseduesi i armës, në këtë rast i dënuari, ka detyrimin që me rastin e skadimit të afatit për lejen e armës të aplikojë për t’u pajisur me leje të re.

5. Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm (Neni 367, KPK)

5.1 Shqyrtime të përgjithshme

Vepra penale e përdorimit të armës apo mjetit të rrezikshëm në fakt është një inkriminim i dyfishtë pasi në një dispozitë janë mishëruar dy aspekte të kësaj vepre penale, pra përdorimi i armës dhe po ashtu edhe i mjetit të rrezikshëm. Ndërsa arma është përkufizuar te ligji përkatës i armëve, i pa përkufizuar mbetet mjeti i rrezikshëm dhe si i tillë mund të shkaktojë dilema në praktikën gjyqësore.

Teksti ligjor:

NENI 367

Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm

- (1) Kushdo që përdor armë apo materie plasëse në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
- (2) Kushdo që përdor armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, dënohet me gjobë deri në dhjetëmijë (10.000) Euro dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.
- (3) Arma apo mjeti i rrezikshëm i përdorur në kundërshtim të këtij neni konfiskohet.

Paragrafi 1

Sipas paragrafit 1 të nenit 367 të KPK-së, veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale përbëhet nga përdorimi i armës ose materieve plasëse në kundërshtim me ligjin e zbat-

ueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse¹⁰⁰ të tilla, për të cilin veprim është parashikuar dënim me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. Pra, për shkak të rrezikshmërisë së kësaj vepre penale del se për këtë formë është paraparë vetëm dënimi me burgim.

Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, rezulton se veprimet kryese të kësaj forme të veprës penale përbëhen nga përdorimi i armës ose materieve plasëse në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla.

Siç shihet, kjo formë e veprës penale ka dy (2) variante të saj, *i pari*, përdorimi i armës në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët dhe *i dyti*, përdorimi i materieve plasëse në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me materiet plasëse.

Kjo vepër penale është përcaktuar me normë “blanketë”, meqë për të ekzistuar kjo formë e veprës penale në të dy (2) variantet e saj, duhet që veprimet kryese, përkatësisht përdorimi i armës apo materieve plasëse, të bëhen në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse, që do të thotë se edhe kjo vepër penale është me karakter “blanketë”.

Duhet theksuar faktin se kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje dhe qëllimi i kryesit duhet të jetë në përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm.

Në këtë mënyrë, nëse veprimet e lartcekura ndërmerren në bazë të ligjit përkatës dhe nga personat e autorizuar, atëherë të njëjtat nuk konsiderohen vepër penale.

Paragrafi 2

Forma e kualifikuar e kësaj vepre penale e parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni vjen në shprehje në rastet kur personi përdor armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, ndërsa për këtë formë të kualifikuar është parashikuar dënim me gjobë deri në dhjetëmijë (10.000) euro dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Lidhur me veprimet kryese të kësaj vepre penale, duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, rezulton se veprimet kryese të kësaj forme të rëndë të veprës penale përbëhen nga përdorimi i armës ose mjetit të rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, pra përjashtohet mundësia e përdorimit të armës në ahengje të ndryshme, por kjo pa qëllim të frikësimit.

Pasojë e kësaj vepre penale është krijimi i rrezikut për integritetin trupor apo shëndetësor të personit tjetër, meqë bëhet fjalë për aspekt të rrezikimit abstrakt përmes kësaj vepre penale.

Për këtë formë të kualifikuar të veprës penale është parashikuar dënim me gjobë deri në dhjetëmijë (10.000) euro dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

100 Ligji nr. 04/L-022 për Përdorimin Civil të Eksplozivëve, datë 29.07.2011.

Kjo vepër penale në të gjitha format e saj mund të kryhet vetëm me dashje, pra mund të kryhet me dashje të drejtpërdrejtë, por edhe me dashje eventuale.

Kryes apo autor i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Gjithashtu, është e rëndësishme të sqarohet se veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, mund ta kryejë si personi që posedon leje për mbajtjen e armës, ashtu edhe personi që nuk posedon leje për mbajtjen e armës.

Nëse personi i cili nuk posedon leje për mbajtjen e armës përdor armën në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, atëherë konsiderohet se ka kryer dy (2) vepra penale dhe atë: veprën penale *“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”* nga neni 366 i KPK-së dhe veprën penale *“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”* nga neni 367 i KPK-së.

Paragrafi 3

Në paragrafin 3 të nenit të lartcekur është parashikuar konfiskimi i detyrueshëm i armës apo mjetit të rrezikshëm, pra konfiskimi bëhet pa marrë parasysh faktin se personi ka pasur leje për mbajtjen e armës.

Analizë e lëndëve nga praktika gjyqësore:

I Në çështjen penale sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.23/2023, datës 22.02.2023, për shkak të veprës penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367, paragrafi 1 i KPK-së, i cili aktgjykim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR. nr.180/2023, datë 24.11.2023.

I pandehuri I.H., shtetas i Kosovës, ishte akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të veprës penale *“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”* nga neni 367, paragrafi 1 i KPK-së, pasi në ditën kritike kishte përdorur armën, pistoletë e tipit *“ZIG 14 Tisas Turkiye RKS 2020”*, për posedimin e së cilës kishte leje të vlefshme nga organet kompetente.

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin I.H., e ka shpallur fajtor për kryerjen e kësaj vepre penale dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje tetë (8) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në afat prej dy (2) vjetësh, nga dita kur ky aktgjykim merr formën e prerë, nuk kryen ndonjë vepër penale tjetër. Gjithashtu, ka urdhëruar konfiskimin e armës, pistoletë e tipit *“ZIG 14 Tisas Turkiye RKS 2020”*. Kurse, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin e lartcekur, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit I.H., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë rast është ngritur si çështje konfiskimi i armës së tipit pistoletë, pasi i pandehuri kishte pasur leje të vlefshme të lëshuar nga organet kompetente për posedimin e kësaj arme.

Në lidhje me çështjen e konfiskimit, në rastin konkret, por edhe në raste të tjera nga praktika jonë gjyqësore është përqaftuar qëndrimi se arma duhet të konfiskohet, pavarësisht faktit se i pandehuri kishte pasur leje të vlefshme të lëshuar nga organet kompetente për posedimin e saj, pasi arma kishte qenë mjet për kryerjen e veprës penale *“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”* nga neni 367, paragrafi 1 i KPK-së, ndërsa në paragrafin 3 të këtij neni është parashikuar konfiskimi i detyrueshëm i armës apo mjetit të rrezikshëm. Në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit I.H., aktgjykimi i ankimuar kundërshtohet edhe përkitazi me vendimin për konfiskim, me arsyetimin se është e vërtetë se ditën kritike i pandehuri e ka përdorur armën, mirëpo, pasi në rastin konkret armën në fjalë e ka poseduar me leje të organeve kompetente, kërkon që arma në fjalë t’i kthehet të akuzuarit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e cekura si më lart nuk qëndrojnë, ngase, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 367, paragrafi 3 të KPK-së, të pandehurit i ka konfiskuar edhe armën, si mjet të kryerjes së veprës penale, ngase, me armën në fjalë, është kryer vepra penale e lartcekur, andaj edhe konfiskimi i armës është i obligueshëm dhe atë pavarësisht fakteve dhe rrethanave se a është poseduar leja apo jo nga organet kompetente për armën në fjalë, për çka, edhe kjo gjykatë ankesën e mbrojtësit të akuzuarit e refuzoi si të papabazuar.

II Në çështjen penale sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.951/2022, datë 16.08.2021, për shkak të veprës penale *“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”* nga neni 367, paragrafi 1 i KPK-së, i cili aktgjykim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.1194/2021, datë 09.11.2021, si dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin Pml.nr.105/2022, datë 16.03.2022.

I pandehuri F.H., shtetas i Kosovës, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të veprës penale *“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”*, të parashikuar me nenin 367, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, pasi më 18.02.2021, në shtëpinë e tij në Prishtinë, ku i pandehuri banon me të dëmtuarin, të atin Sh.H., dhe anëtarët e tjerë të familjes së tij, i pandehuri ndaj të dëmtuarit ka përdorur armën e tipit *“Ekol Special 99”*, në mënyrë kërcënuese, në atë mënyrë që pas mosmarrëveshjeve të mëparshme, por edhe pas mosmarrëveshjes në ditën kritike, kur i pandehuri ishte duke ushtruar dhunë në familje kundër të dëmtuarit Sh.H., pas fjalosjes ku i kishte thënë *“mos gabo të më prekësh me dorë”*, i pandehuri e merr revolen duke e drejtuar nga i dëmtuari në mënyrë kërcënuese. Ndërkohë që e përgatit armën për gjuajtje dhe afrohet në drejtim të të dëmtuarit, i pandehuri rrëshqet në papuçet e të dëmtuarit dhe revolva shkrep dhe qëllon kolltukun në dhomën e pritjes ku ishte edhe i dëmtuari.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin F.H., e ka shpallur fajtor për shkak të kësaj vepre penale dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgj-

jatje prej tre (3) vjet e gjashtë (6) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2000) euro, si dhe ka urdhëruara konfiskimin e përhershëm të revoles së tipit “*Ekol Special 99*”.

Kurse, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin e lartcekur, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Çështja e ngritur në këtë rast nga mbrojtja ka të bëjë me atë se, kur konsiderohet se arma është përdorur në mënyrë kërcënuese, përkatësisht pretendohet se arma nuk është përdorur në mënyrë kërcënuese, dhe kërkohet që vepra penale të ricilësohet sipas paragrafit 1 të nenit 367 të KPK-së, si dispozitë më e favorshme për të pandehurin.

Në lidhje me çështjen e lartcekur, gjykatat kompetente kanë arsyetuar se me veprimet e tilla të të pandehurit konsiderohet se është kryer vepra penale sipas nenit 367 paragrafi 2 të KPK-së, meqë arma është përdorur në mënyrë kërcënuese.

Gjithashtu, edhe Gjykata Supreme e Kosovës, duke shqyrtuar pretendimet konkrete të paraqitura në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit, ka konstatuar se është vërtetuar fakti se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale “*Përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm*” nga neni 367, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së. Meqë ishte konfirmuar fakti se i pandehuri F.H., kishte përdorur revolen e tij në mënyrë kërcënuese pas një mosmarrëveshjeje me tani të dëmtuarin SH.H., dhe se kishte shkrepur një plumb, gjë që nuk kontestohet as nga vetë i pandehuri dhe kjo është vërtetuar edhe përmes provave të administruara nga ana e dy gjykatave të instancave më të ulëta gjyqësore. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, për t’u realizuar elementet e veprës penale për të cilën i pandehuri ishte shpallur fajtor dhe i ishte shqiptuar dënim, përkatësisht nga dispozita e nenit 367, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, është e nevojshme të plotësohen në mënyrë kumulative të dy (2) elemente përbërëse të saj. Së pari, të përdoret përkatësisht të shkrepet revolja, i cili element nuk ishte kontestues pasi nga arma e tipit “*Ekol Special 99*”, ishte shkrepur një plumb. Së dyti, përdorimi i armës duhet të realizohet në mënyrë kërcënuese, i cili element rrjedh se është realizuar nga mosmarrëveshjet e krijuara në raportin mes të pandehurit dhe të dëmtuarit. Andaj me realizimin në mënyrë kumulative e këtyre dy elementeve plotësisht realizohet vepra penale dhe në këtë kontekst nuk kërkohet ndonjë pasojë eventuale.

6. Lejet, pëlqimet dhe licencat e rreme të armëve dhe dhënia e informatave të rreme (Neni 368, KPK)

6.1 Shqyrtime të përgjithshme

Vepra penale “Lejet, pëlqimet dhe licencat e rreme të armëve dhe dhënia e informatave të rreme” në fakt është vepër penale e cila është e lidhur ngushtë me dy vepra të tjera penale që u trajtuan më lart dhe paraqet vepër penale të veçantë që ndërlidhet me dhënien e lejeve, pëlqimeve dhe licencave të rreme të armëve apo dhënien e informacioneve të rreme për t’u pajisur me leje për armë.

Teksti ligjor:

NENI 368

Lejet, pëlqimet dhe licencat e rreme të armëve dhe dhënia e informatave të rreme

- (1) Kushdo që jep informata të rreme, qoftë gojarisht apo me shkrim, në cilëndo fazë të procedurës së aplikimit për leje, pëlqim apo licencë të mbajtjes së armës apo mjetit plasës, dënohet me gjobë deri në pesëmijë (5.000) Euro ose me burgim deri në tre (3) vjet.
- (2) Kushdo që prodhon, posedon, shet ose blen leje, pëlqim apo licencë të rreme të mbajtjes së armës apo mjetit plasës, dënohet me gjobë deri në pesëmijë (5.000) Euro ose me burgim deri në tre (3) vjet.

- (3) Kushdo që mban lejen, licencën apo ndonjë autorizim tjetër për mbajtjen e armëve apo mjeteve plasëse dhe nuk ia tregon menjëherë lejen, licencën apo autorizimin tjetër policisë apo KFOR-it sipas kërkesës së tyre, dënohet me gjobë deri në dymijë e pesëqind (2.500) Euro ose me burgim deri në tre (3) muaj. Nëse kryesi nuk e ka lejen apo licencën në posedim në kohën e kërkesës dhe ai nuk njofton policinë apo KFOR-in për vendndodhjen e lejes, licencës apo autorizimit tjetër, kryesi dënohet me gjobë deri në dymijë e pesëqind (2.500) Euro ose me burgim deri në tre (3) muaj.
- (4) Leja, licenca apo autorizimi tjetër i rremë konfiskohet. Mjetet për prodhimin e lejes, licencës apo autorizimit tjetër të rremë konfiskohen.

Paragrafi 1

Siç shihet edhe nga neni 368 i KPK-së, kjo vepër penale ka të bëjë me dhënien e informacioneve të rreme lidhur me lejet, pëlqimet dhe licencat e armëve, ndërsa në vete përmban formën themelore dhe dy (2) forma të rënda apo të kualifikuara.

Dhënia e informacioneve të rreme mund të bëhet gojarisht apo me shkrim. Përmes kësaj dispozite janë inkriminuar veprimet paraprake me rastin e aplikimit për leje, pëlqim apo licencë për armë apo mjete plasëse. Pra, këtu është përcaktuar se dhënia e informacioneve të rreme përbën vepër penale të veçantë në rast të paraqitjes së të dhënave të rreme.

Paragrafi 2

Forma e dytë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 2 të nenit të lartcekur dhe konsiderohet që kryhet në rastet kur personi prodhon, posedon, shet ose blen leje, pëlqim apo licencë të rreme për mbajtjen e armës apo mjetit plasës.

Veprimet kryesë të kësaj forme të veprës penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe përbëhen nga prodhimi, posedimi, shitja ose blerja e lejeve, pëlqimeve apo licencave të rreme për mbajtjen e armës apo mjetit plasës.

Paragrafi 3

Variantin e parë të kësaj forme të veprës penale e kryen kushdo që mban lejen, licencën apo ndonjë autorizim tjetër për mbajtjen e armëve apo mjeteve plasëse dhe nuk ia tregon menjëherë lejen, licencën apo autorizimin tjetër policisë apo KFOR-it sipas kërkesës së tyre.

Për këtë variant të kësaj forme të veprës penale është parashikuar dënim me gjobë deri në dymijë e pesëqind (2.500) Euro ose me burgim deri në tre (3) muaj.

Variantin e dytë kësaj forme të veprës penale e kryen personi i cili nuk e ka lejen apo licencën në posedim në kohën e kërkesës dhe ai nuk njofton policinë apo KFOR-in për vendndodhjen e lejes, licencës apo autorizimit tjetër. Për këtë variant të kësaj forme të veprës penale është parashikuar dënim me gjobë deri në dymijë e pesëqind (2.500) euro ose me burgim deri në tre (3) muaj.

Kjo vepër penale në të gjitha format e saj mund të kryhet vetëm me dashje, kurse kryes i kësaj veprë penale mund të jetë çdo person.

Paragrafi 4

Gjithashtu, edhe te kjo vepër penale është parashikuar konfiskimi i detyrueshëm i lejes, licencës apo autorizimit të rremë, si dhe mjeteve për prodhimin e tyre.

7. Prodhimi dhe sigurimi i armëve dhe mjeteve për kryerjen e veprave penale (Neni 369, KPK)

7.1 Shqyrtime të përgjithshme

Vepra penale “*Prodhimi dhe sigurimi i armëve dhe mjeteve për kryerjen e veprave penale*” përfshin veprime të tilla të cilat në kushte dhe rrethana të caktuara mund të paraqesin veprime përgatitore apo veprime të ndihmës në kryerjen e veprës penale dhe të cilat janë të përcaktuara si inkriminime të veçanta.

Teksti ligjor:

NENI 369

Prodhimi dhe sigurimi i armëve dhe mjeteve për kryerjen e veprave penale

- (1) Kushdo që prodhon, siguron ose i mundëson personit tjetër që të sigurojë armë apo helme ose pajisje tjera të nevojshme për prodhimin e tyre, për të cilat e di se janë të destinuara për përdorimin ose kryerjen e veprës penale, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.
- (2) Kushdo që prodhon, siguron ose i mundëson personit tjetër që të siguroj çelës të falsifikuar, kallauz ose pajisje tjera për përdorim në plaçkitje, për të cilat e di se janë të destinuara për përdorimin ose kryerjen e veprës penale, dënohet me burgim deri në një (1) vit.

Kjo vepër penale përmban dy (2) forma të kryerjes dhe atë: formën themelore që është parashikuar në paragrafin 1 dhe formën e lehtë që është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni.

Paragrafi 1

Veprimet kryese të formës themelore të kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe përbëhen nga prodhimi, sigurimi ose mundësimi i personit tjetër që të sigurojë armë apo helme ose pajisje tjera të nevojshme për prodhimin e tyre, për të cilat e di se janë të destinuara për përdorimin ose kryerjen e veprës penale.

Vepra penale kryhet me ndërmarrjen e një veprimi alternativ, siç është përshkruar në përshkrimin e veprës penale në prodhimin, sigurimin apo mundësimin pa marrë parasysh se a është kryer vepra penale apo ka mbetur në tentativë. Kurse vepra penale kryhet me dashje (dolus) e që kjo nënkupton vetëdijen e kryesit që përmes veprimit të tij mundëson që tjetri të kryejë veprën penale.

Është e rëndësishme të theksohet fakti se nëse ndihma është premtuar paraprakisht, atëherë nuk realizohet kjo vepër penale, por realizohet vepra penale e dhënies së ndihmës në kryerjen e veprës penale.

Për këtë vepër penale është parashikuar dënim me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.

Objekti i kësaj vepre penale janë armët, helmet ose pajisjet tjera të nevojshme për prodhimin e tyre, e që përmes këtyre të mundësohet kryerja e veprës penale.

Paragrafi 2

Kurse, forma e privilegjuar e kësaj vepre penale realizohet kur e kryen personi që prodhon, siguron ose i mundëson personit tjetër të sigurojë çelës të falsifikuar, kallauz ose pajisje të tjera për përdorim në “plaçkitje”, për të cilat e di se janë të destinuara për përdorimin ose kryerjen e veprës penale. Për këtë formë të veprës penale është parashikuar dënim me burgim deri në një (1) vit.

Veprimet kryese të formës së lehtë të kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe përbëhen nga prodhimi, sigurimi ose mundësimi që personi tjetër të sigurojë çelës të falsifikuar, kallauz ose pajisje të tjera për përdorim në “plaçkitje”. Pajisjet e tjera mund të jenë të llojeve të ndryshme por ato duhet të mundësojnë kryerjen e veprës penale dhe mund të jenë pajisje të sistemeve të sigurisë apo aparate të tjera të sigurisë, e që kjo mund të realizohet përmes dhënies së kodeve të fshehta për deaktivizim të këtyre pajisjeve të cilat mundësojnë lehtësimin e kryerjes së veprës penale.

Kurse, autori duhet të jetë në dijeni që sendi i prodhuar apo i siguruar është mjet që do të përdoret për “plaçkitje”.

Ligjvënësi ka përdorur shprehjen “plaçkitje”, e cila konsiderojmë se nuk është adekuate pasi kjo shprehje është e paqartë dhe meqë vepër penale të plaçkitjes nuk ka në kodin penal. Tute, për krahasim, mund të merret parasysh edhe fakti se në legjislacionin penal të Kroacisë përdoret shprehja “thyerje” e cila nënkupton hyrjen me thyerje në objekte.

Objekti i kësaj vepre penale janë çelësat e falsifikuar, kallauzët ose pajisjet e tjera për përdorim në “plaçkitje”.

Përndryshe, kjo vepër konsiderohet se është kryer në rastet kur sendet e përcaktuara janë prodhuar apo i janë dhënë në dispozicion personit tjetër, kurse fakti se me këto mjete është kryer apo nuk është kryer vepra penale nuk ka ndikim në ekzistimin e veprës penale, meqë inkriminimi ligjor bën fjalë vetëm për dhënien në dispozicion të mjetit për kryerjen e veprës penale.

Bibliografia

I. Libra dhe botime të tjera

ALEXANDER,
LARRY; FERZAN
KIMBERLY KESSLER

Crime and Culpability, A Theory of Criminal Law,
Cambridge, 2009.

BERGMAN, PAUL;
BERGMAN-
BARRET, SARA

*The Criminal Law Handbook, Know Your Rights, Survive the
System*, Fifth Edition, Berkeley, 2003.

BIANKU, LEDI;
KUMBARO, ODETA

Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, Botimi i katërt,
Strasburg, 2017.

BOHLANDER,
MICHAEL

Principles of German Criminal Law, Oxford and Portland,
Oregon, 2009.

DRESSLER, JOHN

Criminal Law, Third Edition, Santa Monica, 1996.

ELEZI, ISMET;
KAÇUPI, SKËNDER;
HAXHIA, MAKSIM

Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Pjesa e
Përgjithshme, Tiranë, 2004.

ELLIOT, CATHERINE;
QUIN, FRANCES

Criminal Law, Third Edition, "Pearson Education", Harlow, 2000.

FLETCHER, GEORGE

Basic Concepts of Criminal Law, Oxford University Press, New
York-Oxford, 1998.

- GASHI, REXHEP *Krimi i organizuar*, Prishtinë, 2023.
- FIONDA, JULIA;
BRYANT, MICHAEL *Briefcase on Criminal Law*, Second Edition, Cavendish Publishing Limited, London, 2000.
- HAJDARI, AZEM *Procedura penale, Komentar*, Prishtinë, 2009.
- HALL, E. DANIEL *Criminal Law and Procedure*, Fifth Edition, Delmar Cengage, New York, 2009.
- HALLEVY, GABRIEL *A Modern Treatise on the Principle of Legality in Criminal Law*, Sprinder, London, 2010.
- HALPIN, ANDREV *Definition in the Criminal Law*, Hart Publishing, Oxford, 2004.
- HERRING, JONATHAN *Criminal law*, Third Edition, "Palgrave Maxmillan", Bristol, 2002.
E drejta penale, Teori, kazuse dhe materiale, Botim V/Volumi I, Tiranë, Tetor 2013. Criminal Law, The Basic, Routledge, Abingdon, 2010
- HASANI, FEJZULLAH *Vrasja në gjendje të tronditjes së fortë mendore*, Prishtinë, 2019.
- ISMAILI, HILMI;
SEJDIU, FATMIR *Historia e përgjithshme e shtetit dhe e së drejtës*, Prishtinë, 2000.
- KAMBOVSKI, VLLADO *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, Shkup, 2007.
- KAPLAN, JOHN *Criminal Law*, Third Edition, Boston, 1996.
- KASSAB, HANNA;
ROSEN, JONATHAN *Illicit Markets, Organized Crime, and Global Security*, 2019.

KOKOLJ, MIRKO	<i>Diskutim për printimin 3D dhe armët e zjarrit</i> , SEECAC, 2016.
LATIFI, VESEL; DEMOLLI, HAKI	<i>Kriminalistika - zbulimi dhe të provuarit e krimit</i> , Prishtinë, 2019.
LUARASI, ALEKS	<i>Kodi penal me praktikë gjyqësore</i> , Tiranë, 2003.
MALIQI, AGIM; SHALA, AFRIM	<i>Përmbledhje me raste nga praktika gjyqësore lidhur me armët e zjarrit, Volume 1 2020-2024</i> , E drejta penale dhe praktika gjyqësore në Kosovë, Prishtinë, 2024.
MOLAN, MIKE	<i>Cases and materials on criminal law</i> , Fourth Edition, London and New York, 2008.
JEAN, PRADEL; CORSTENS, GEERT; VERMEULEN, GERT	<i>E drejta penale evropiane</i> , Tiranë, 2009.
SAHITI, EJUP; MURATI, REXHEP	<i>E drejta e procedurës penale</i> , Prishtinë, 2016.
SALIHU, ISMET	<i>Kodi Penal i Kosovës</i> , Prishtinë, 2016. <i>E drejta penale</i> , Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015. <i>E drejta penale</i> , Pjesa e posaçme, Prishtinë, 2014.
SALIHU, ISMET; ZHITIJA, HILMI; HASANI, FEJZULLAH	<i>Kodi Penal i Kosovës, Komentar</i> , Botimi I, 2014, Prishtinë.
SAMAHA, JOEL	<i>Criminal Law</i> , Tenth Edition, Wadsworth, Cengage Learning, 2011.

SHALA, AFRIM

Kompetencat e gjyqtarit të procedurës paraprake sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Revista “Justicia”, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, 2009.

Ankesa kundër aktgjykimit në procedurën penale të Kosovës, Prishtinë, 2010.

Pjesa e posaçme e së drejtës penale me raste nga praktika gjyqësore, Gjilan, 2010.

Përmbledhje e ligjëratave nga “E drejta penale I”, Gjilan, 2011.

Sistemet kryesore të caktimit të dënimit me gjobë në të drejtën penale bashkëkohore, Revista “E drejta”, Nr.2-2011, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Prishtinë, 2011, faqe 129-136.

Roli i shërbimit sprovues në shqiptimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative, Gjilan, 2011.

Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore sipas Kodit Penal të Kosovës, Revista “Avokatura”, nr. 14, Oda e Avokatëve të Kosovës, Prishtinë, 2012, faqe 15-31.

Organizimi i sistemit gjyqësor në Kosovë sipas Ligjit për gjykatat, Revista shkencore “Norma”, Gjilan, 2012.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Moduli Trajnues, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë, 2012, (bashkautor).

Veprat penale kundër të drejtave të votimit, “Opinio Juris”, Revistë shkencore juridike, Akademia e Drejtësisë, Viti I, nr.1, Prishtinë, 2015.

Doracaku për procedurë penale, Prishtinë, 2015, (bashkautor).

Disa aspekte praktike të seancës për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me dënimin, Revista shkencore juridike “Opinio Juris”, Akademia e Drejtësisë, Viti II, nr. 2, Prishtinë, 2016.

Shqyrtimi fillestar, shqyrtimi i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor, Akademia e Drejtësisë, Prishtinë, 2018.

Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional (Penale-materiale dhe procedurale), Prishtinë, Prishtinë, 2021, (bashkautor).

Shqyrtimi gjyqësor dhe gjykimi në mungesë, Akademia e Drejtësisë, Prishtinë, 2012.

Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale, Akademia e Drejtësisë, Prishtinë, 2023 (bashkautor).

Hyrje në të drejtën penale, Botimi i katërt, Prishtinë, 2023.

Përmbledhje nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në çështjet penale dhe civile, Prishtinë, 2023 (kontribuues).

Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Supreme të Kosovës, Prishtinë, 2023, (kontribuues).

Mbrojtja e mjedisit përmes të drejtës penale, Tiranë, 2023.

SHALA, AFRIM; ADEMI, BURIM; KUQI, RAMIZ *Drejtësia Mjedisore, Prishtinë, 2024.*

II. Publikime të tjera

Udhëzues për politikën ndëshkimore, Botimi 1, Gjykata Supreme e Kosovës, Prishtinë, 2018.

Udhëzues për politikën ndëshkimore, Gjykata Supreme e Kosovës, Prishtinë, 2024.

Përmbledhje e ligjeve penale, Instituti i Kërkimeve Juridike dhe Shoqërore, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 1979.

Kontrolli i armëve të vogla dhe të lehta në Kosovë, Forumi për Siguri, Prishtinë, Mars, 2012.

Politika ndëshkimore në rastet e posedimit të paligjshëm të armëve, OSBE-Kosovë, Prill, 2024.

Raport për analizën gjinore të kuadrove ligjorë dhe politikë të kontrollit të armëve të vogla në Kosovë, SEESAC, 2021.

III. Akte juridike (vendore dhe ndërkombëtare)

Kodet Penale të Kosovës (2004, 2013 dhe 2019);

Kushtetuta e Kosovës;

Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, i datës 01.07.1977;

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Rregullorja (BE) nr.258/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14.03.2012, që implementon nenin 10 të Protokollit të Kombeve të Bashkuara kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional;

Direktiva e Këshillit 91/477/KEE për kontrollin e blerjes dhe posedimit të armëve të zjarrit, e ndryshuar me Direktivën 2008/51/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21.05.2008, dhe 2017/853, datë 17.05.2017;

Direktiva (EU) 2021/555 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 24.03.2021, për kontrollin e blerjes dhe posedimit të armëve;

Konventa Evropiane për Kontrollin e Blerjes dhe Posedimit të Armëve të Zjarrit nga Individët, datë 28.06.1978;

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional e miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, nr. 55/25, datë 15.11.2000;

Protokolli kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve, datë 31.05.2001;

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Këshilli i Evropës, 1950;

Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, datë 10.12.1948;

Ligji nr. 05/L-022 për Armë, datë 23.07.2015;

Ligji nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike, datë 29.07.2013;

Ligji nr. 08/L-176 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, datë 15.06.2023;

Ligji nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri, datë 28.10.2010;

Ligji nr. 05/L -017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për Pajisje me Armë, Municion dhe Pajisje Përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri, datë 23.07.2015;

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/7 për Autorizimin e Posedimit të Armëve në Kosovë, datë 04.06.2001;

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24, datë 12.12.1999;

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/59, datë 27.10.2000;

Ligji nr.74/2014 për Armët i Republikës së Shqipërisë, datë 10.07.2014;

Ligji për Armët i Republikës së Kroacisë, datë 01.06.2007;

Udhëzimi Administrativ nr. 25/2010 - MPB për Gjurmimin e Armëve të Zjarrit, Pjesëve të tyre dhe Municionit;

Udhëzimi Administrativ nr. 26/2010 - MPB për Shënjimin e Armëve të Zjarrit, Pjesëve dhe Municionit të tyre;

Udhëzimi Administrativ nr. 15/2010 - MPB për Legalizimin e Armëve të Zjarrit që i takojnë Kategorisë B, C dhe D1;

Udhëzimi Administrativ nr. 08/2023 - MPB për Objektet dhe Procesin Teknologjik të Prodhimit të Armëve, Pjesëve të Armëve dhe Municionit;

Udhëzimi Administrativ nr. 03/2016 - MPB për Leje për Lëvizje me Armë;

Udhëzimi Administrativ nr. 24/2010 - MPB për Procedurat e Trashëgimisë për Armë dhe Municion në rast të Vdekjes së Pronarit të Armës së Zjarrit,

Udhëzimi Administrativ nr. 08/2016 - MPB për Kushtet Minimale Teknike për ruajtjen e Armës, Pjesëve të Armës dhe Municionit.

